VENDIM
Nr. 824, datë 18.12.2019

PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË SEKTORIALE TË MENAXHIMIT TË FINANCAVE PUBLIKE 2019-2022

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 16, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e Strategjisë Sektoriale të Menaxhimit të Financave Publike, 2019–2022, dhe të planit të veprimit të saj, sipas dokumentit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Vendimi nr. 908, datë 17.12.2014, i Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e Strategjisë Sektoriale për Menaxhimin e Financave Publike, 2014-2020", shfuqizohet.
3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe të gjitha institucionet e përmendura në strategjinë dhe planin e veprimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

STRATEGJIA SEKTORIALE E MENAXHIMIT TË FINANCAVE PUBLIKE
2019–2022
Tetor 2019

Përmbledhje ekzekutive

Ky dokument është strategjia sektoriale e rishikuar për reformën e Menaxhimit të Financave Publike (MFP) e qeverisë së Shqipërisë (QSH), për periudhën 2019–2022[1]. Zëvendëson strategjinë e mëparshme, bazuar në rishikimin afatmesëm të vitit 2018 (RA) të strategjisë, e cila drejtohej nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE). Për të mundësuar shtyrjen e asistencës së Instrumentit për Paraanëtarësim (IPA), MFE-ja e shtyu strategjinë dhe planin e veprimit edhe dy vjet të tjera pas vitit 2020, pra deri në vitin 2022. Strategjia e rishikuar e ndihmon QSH-në të përfshijë edhe masat e nevojshme për MFP-në, që kanë dalë që prej vitit 2014, në mënyrë që këto prioritete të trajtohen efektivisht. Megjithëse në strategji janë pasqyruar ndryshimet, është ruajtur baza me të njëjtin vizion dhe objektiv të përgjithshëm:

Vizioni i strategjisë së reformës së MFP-së është garantimi i një sistemi të financave publike që nxit transparencën, llogaridhënien, disiplinën fiskale dhe efikasitetin në menaxhimin dhe përdorimin të burimeve publike për ofrimin e shërbimeve të përmirësuara dhe zhvillimin ekonomik.

Objektivi i përgjithshëm i strategjisë është që të mundësojë një buxhet më të mirëbalancuar dhe të qëndrueshëm me një raport të ulur të borxhit nëpërmjet kontrollit dhe menaxhimit më të fortë financiar, si dhe me anë të proceseve audituese, ku zbatimi i buxhetit të jetë i lidhur siç duhet me politikat e qeverisë.

Në kapitullin 1 shpjegohen konteksti dhe historiku, si dhe organizimi dhe synimet e strategjisë së MFP-së. Shqipëria ka pësuar tashmë një rritje më të madhe. Produkti i brendshëm bruto (PBB) ka pasur një tendencë në rritje për pesë vjet radhazi. Në këtë pikë, QSH-ja mbetet e angazhuar të

[1]Në vazhdim "Strategjia e menaxhimit të e financave publike".

vijojë reformat strukturore, përfshirë forcimin e shtetit të së drejtës dhe institucioneve ekonomike, të heqë pengesat për kursime më të mëdha private dhe investime, të reduktojë borxhin publik me ritëm më të shpejtë, duke përmirësuar menaxhimin e investimeve publike dhe duke zgjeruar bazën e të ardhurave.

Kapitulli 1 vijon me prezantimin e progresit kryesor që është bërë qysh prej vitit 2014, për secilën nga gjashtë shtyllat së bashku me mësimet e nxjerra nga Raporti i Rishikimit Afatmesëm (RRA), që vë në dukje problemet që lidhen me koordinim e monitorimit, vonesat në forcimin e kuadrit ligjor dhe atij rregullator, problemet institucionale që vijnë si pasojë e mungesës së kapaciteteve dhe ndërprerjet që shkaktoi riorganizimi i qeverisë. Gjithashtu, janë përmbledhur gjetjet dhe rekomandimet kyçe nga vlerësime që kanë ndërmarrë donatorët dhe partnerët për zhvillim për reformën e MFP-së, të cilat janë të dobishme për të identifikuar reformat kryesore që nevojiten për të ecur përpara.

Strategjia është riorganizuar për të pasqyruar ndryshimin e prioriteteve të reformës së MFP-së nga viti 2014 dhe që tani adresohet përmes shtatë (në vend të gjashtë) "objektivave specifikë" (më parë shtyllat), në përputhje me kuadrin e rishikuar të planifikimit strategjik dhe monitorimit që është prezantuar së fundmi nga zyra e Kryeministrit (ZKM):

Objektivi specifik 1. Kuadër fiskal i qëndrueshëm dhe i matur
Objektivi specifik 2. Planifikim i mirintegruar dhe efikas
Objektivi specifik 3. Mbledhja e të ardhurave
Objektivi specifik 4. Zbatim efikas i buxhetit
Objektivi specifik 5. Transparencë e financave publike
Objektivi specifik 6. Kontroll i brendshëm efektiv
Objektivi specifik 7. Mbikëqyrje e jashtme efektive e financave publike

Strategjia përmban rezultate specifike, të matshme, të arritshme, realiste dhe në kohë (SMART) për secilin nga objektivat specifikë, të cilat shoqërohen me ndërhyrjet (komponentët) e kapitullit 2. Çdo objektiv specifik ka përshkrimin e progresit që prej vitit 2014, krahas mësimeve të nxjerra dhe prioriteteve për periudhën 2019–2022. Ndërhyrjet kryesore janë lidhur drejtpërdrejtë me rezultatet, si dhe janë identifikuar aktorët kyçë për të garantuar linja të qarta të llogaridhënies. Gjithashtu, janë identifikuar qartë produktet për secilin komponent brenda objektivit specifik.

Me anë të objektivit specifik 1, qeveria synon të krijojë një kuadër makroekonomik të matur dhe politika fiskale që kanë si objektiv uljen e raportit të borxhit ndaj PBB-së në planin afatmesëm në 60 për qind, si dhe menaxhimin e risqeve fiskale në mënyrë më efektive.

Qeveria e pranon nevojën për të përafruar më tej dokumentet planifikuese strategjike, si: Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI II), strategjitë sektoriale dhe Programi Buxhetor Afatmesëm (PBA), që është dhe fokusi i objektivit specifik 2. Buxheti vjetor dhe proceset e PBA-së do të vazhdojnë të përmirësohen, si dhe do të ulen detyrimet e prapambetura. Gjithashtu, është thelbësore që Menaxhimi i Investimeve Publike (MIP) të kanalizohet midis MFE-së dhe KM-së që të forcohet mbikëqyrja e tij.

Rritja e mbledhjes së të ardhurave, duke rritur efikasitetin në mbledhjen e burimeve të të ardhurave, që mbulon si tatimet edhe doganat, duke sjellë kështu më shumë qëndrueshmëri në financimin e buxhetit, si në nivel qendror dhe vendor është fokusi i objektivit specifik 3. Gjithashtu, do të ulet informaliteti.

Objektivat specifikë 1–5 dhe objektivi specifik 4 në veçanti, kanë në fokusin e tyre integrimin e plotë të Sistemit të Informacionit të Menaxhimit Financiar Shqiptar (SIMFSH) me sistemet e tjera të MFP-së, për të minimizuar operacionet manuale dhe për të bërë të mundur që të ketë më shumë saktësi dhe respektim të afateve kohore në raportimin e operacioneve financiare qeveritare. Objektivi kryesor është të garantohet përdorim efektiv dhe efikas i burimeve të miratuara buxhetore. Ndërhyrjet synojnë të ulin detyrimet e prapambetura, të reduktojnë kostot e huamarrjes dhe të rrisin efikasitetin dhe transparencën e sistemit të prokurimit.

Objektivi specifik 5 përpiqet të rrisë llogaridhënien dhe transparencën falë raportimit më të mirë financiar dhe jofinanciar, në përputhje me standardet ndërkombëtare, të përmirësojë mbulimin, cilësinë dhe aksesueshmërinë e informacionit për financat publike. Do të shtohen përpjekjet për të angazhuar publikun në procesin buxhetor.

Disiplina, kontrolli dhe transparenca financiare nëpërmjet përmirësimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (MFK), auditimit të brendshëm dhe inspektimit financiar publik efikas në qeverisjen qendrore dhe vendore është edhe fokusi i objektivit specifik 6.

Së fundmi, objektivi specifik 7 synon të rrisë e të bëjë efektive mbikëqyrjen e jashtme të financave publike, duke forcuar kapacitetet e Kontrollit të Lartë të Shtetit (KLSH). Do të rritet numri i auditimeve financiare dhei auditimeve të performancës, në mënyrë që të rritet edhe vlera e tyre dhe përfitimet në shoqëri.

Gjithashtu, në kapitullin 3 janë paraqitur masat e organizimit institucional, përfshirë rolet dhe përgjegjësitë e palëve të interesit për drejtimin dhe në koordinimin e zbatimit, monitorimit dhe raportimit të strategjisë së MFP-së. Në të njëjtin kapitull gjendet edhe informacioni për arkitekturën e sistemit të MFP-së, lidhjet dhe ndërfaqen e tij. Konfirmohet edhe roli në vazhdimësi që luan Komiteti Drejtues i MFP-së (KD), i cili drejtohet nga MFE-ja. Të paktën një herë në vit, Komiteti do të organizojë një forum për dialog dhe për të marrë vlerësimet e partnerëve të jashtëm të Shqipërisë mbi zbatimin e Strategjisë së MFP-së.

Propozohet që Komiteti Teknik i MFP-së (KT) të përbëhet vetëm nga koordinatorët e objektivave specifikë dhe të komponentëve, për të mundësuar planifikim të detajuar dhe monitorim të planeve vjetore të punës. KD-ja dhe KT-ja do të mbështeten nga Drejtoria e Menaxhimit të Reformës të Financave Publike (DMRFP). Drejtoria do të jetë përgjegjëse për monitorimin dhe raportimin e reformave të MFP-së. Poshtë nivelit të KT-së propozohet të ngrihen shtatë komitete të veçanta koordinimi (KK), një për secilin objektiv specifik, të cilat do të mblidhen të paktën çdo gjashtë muaj, idealisht çdo tre muaj. KK-të drejtohen nga koordinatorët e objektivit specifik dhe anëtarë do të jenë koordinatorët e komponentëve për secilin nga objektivat specifikë. Synimi është të shqyrtohen aktivitetet e hollësishme që janë ndërmarrë, për të mundësuar koordinimin ndërmjet palëve të interesit të komponentëve, në mënyrë që të trajtohen problemet, risqet dhe pengesat, për t'u siguruar që ecuria të jetë sipas planit. Nga ana tjetër, KK-të do të çojnë problemet për zgjidhje deri në nivel KT-je apo KD-je, sipas rastit.

Kapitulli 4 përmban vlerësimin e kostimit dhe të financimit që duhet të planifikojë MFE-ja dhe të integrohet në PBA, si dhe të jetë pjesë e diskutimit me partnerët e jashtëm.

Edhe PBA-ja do të jetë objekt diskutimi me partnerët e jashtëm.

Kapitulli 5 përmban një përmbledhje të Planit të Veprimit të Strategjisë së MFP-së për periudhën 2019–2022 dhe jep një tablo të përgjithshme të Strategjisë bashkë me objektivat specifikë, produktet, afatet kohore të realizimit, njësitë përgjegjëse dhe kostot shoqëruese.

Kapitulli 6 përmban planin e risqeve dhe të zvogëlimit të tyre, i cili është përgatitur për strategjinë e ndryshuar. Për të menaxhuar reformat në mënyrë efektive, bazuar dhe në përvojën e fituar gjatë periudhës 2014–2018, kërkohet menaxhim më aktiv i risqeve. Më shumë vëmendje do t'i kushtohet zbatimit të aktiviteteve, si dhe risqeve potenciale, si dhe përmbushjes së objektivave kryesorë të objektivave specifikë dhe komponentëve të tyre.

Të gjitha aktivitetet, sipas objektivit specifik dhe komponentëve janë hedhur në planin e veprimit, që gjendet në shtojcën 1, dhe rezultatet e secilit objektiv specifik, krahas treguesve të performancës dhe produkteve të aktiviteteve, jepen në tabelën e shtojcës 2.

Shkurtimet dhe akronimet

AB	Auditues i brendshëm
APP	Agjencia e Prokurimit Publik
AT	Asistencë teknike
BE	Bashkimi Evropian
BGJ	Buxhetimi me baza gjinore
BTH	Bono thesari
DAMS	Drejtoria e Analizës Makroekonomike dhe Statistikave

DAPB	Drejtoria e Analizës dhe Programimit Buxhetor
DFV	Drejtoria e Financave Vendore
DHAB	Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm
DHMFKK	Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar, Kontrollit dhe Kontabilitetit
DIFP	Drejtoria e Inspektimit Financiar Publik
DMB	Drejtoria e Menaxhimit të Buxhetit
DMIP	Drejtoria e Menaxhimit të Investimeve Publike
DMRFP	Drejtoria e Menaxhimit të Reformës së Financave Publike
DOTH	Drejtoria e Operacioneve të Thesarit
DPBPKNH	Drejtoria e Përgjithshme e Borxhit Publik dhe Koordinimit të Ndihmës së Huaj
DPD	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave
DPT	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
DPTP	Drejtoria e Përgjithshme e Taksës së Pasurisë
DPTH	Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit
DRF	Deklarata e Risqeve Fiskale
DPZHEP	Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit Ekonomik dhe Punësimit
DZHM	Drejtoria për Zhvillim dhe Mirëqeverisje
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
GSP	Grupi sektorial i punës
IB	Institucion buxhetor
IBH	Indeksi për buxhetin e hapur
IHD	Investime të huaja të drejtpërdrejta
INSTAT	Instituti i statistikave
IPA	Instrumenti për paraanëtarësim
KBFP	Kontrolli i Brendshëm Financiar Publik
KESK	Kontrolli i Eksporteve dhe Siguria Kufitare
KD	Komiteti drejtues
KK	Komitetet e koordinimit
KKAB	Komisioni i Kualifikimit të Audituesve të Brendshëm
KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
KM	Kryeministria
KPP	Komisioni për Prokurimet Publike
KT	Komiteti teknik
LOB	Ligji organik për buxhetin
LPP	Ligji për prokurimin publik
LLUTH	Llogaria unike e thesarit
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MFK	Menaxhimi financiar dhe kontrolli
MFP	Menaxhimi financiar publik
MIP	Menaxhimi i investimeve publike
ML	Ministritë e linjës
MPQM	Mbështetje për përmirësimin e qeverisjes dhe menaxhimit
MSA	Marrëveshja e stabilizim-asocimit
MSFQ	Manuali i statistikave të financave të qeverisë
NSH	Ndërmarrje shtetërore
NJRF	Njësia e riskut fiskal
OBZHE	Organizata për bashkëpunim dhe zhvillim ekonomik
OEA	Operatorë ekonomikë të autorizuar
ONISHA	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Shtetërore të Auditimit
OSHC	Organizatat e shoqërisë civile
PBA	Programi Buxhetor Afatmesëm
PBB	Prodhimi i Brendshëm Bruto
PFA	Planifikimi i Financimit Afatmesëm
PPP	Partneriteti Publik, Privat
PZHI	Partnerët për Zhvillim dhe Integrim
QQ	Qeveria qendrore

QSH	Qeveria e Shqipërisë
QV	Qeveria vendore
RAP	Reforma në administratën publike
RRA	Raporti i rishikimit afatmesëm
SAMB	Strategjia afatmesme për menaxhimin e borxhit
SELL	Sistemi Evropian i Llogarive
SHKA	Shërbimi për Koordinimin Antimashtrim
SKZHI	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim
SIFQ	Sistemi Informacionit Financiar Qeveritar
SIMAJ	Sistemi i Informacionit të Menaxhimit të Asistencës së Jashtme
SIMBNJ	Sistemi i Informacionit të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore
SIMF	Sistemi i Informacionit të Menaxhimit Financiar
SIMFSH	Sistemi i Informacionit të Menaxhimit Financiar Shqiptar
SMART	Specifikë, të matshëm, të arritshëm, realistë dhe në kohë
SMIT	Sistemi i Menaxhimit të Integruar të Tarifave
SNISA	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditit
SNKSP	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik
SPI	Sistemi i Planifikimit të Integruar
SQF	Statistikat qeveritare financiare
SHPPF	Shpenzimet publike dhe përgjegjshmëria financiare
TKP	Treguesit kyç të performancës
TVSH	Tatimi mbi vlerën e shtuar
USPB	Udhëzimi standard për përgatitjen e buxhetit
VMIP	Vlerësimi i Menaxhimit të Investimeve Publike

Kapitulli 1. Hyrja dhe historiku
1.1 Synimi dhe organizimi i Strategjisë së MFP-së
1.2 Qëllimi dhe menaxhimi i Strategjisë së MFP-së
1.3 Konteksti dhe historiku
1.3.1 Konteksti ekonomik dhe fiskal
1.3.2 Ecuria kryesore prej vitit 2014
1.3.3 Mësimet e nxjerra nga Raporti i Rishikimit Afatmesëm (RRA)
1.3.4 Vlerësimi i jashtëm
Kapitulli 2. Objektivat specifikë të strategjisë dhe ndërhyrjet
Objektivi specifik 1. Kuadër fiskal i qëndrueshëm dhe i matur
Komponenti 1.1 Rregullat fiskale dhe parashikimi
Komponenti 1.2 Menaxhimi i riskut fiskal
Objektivi Specifik 2. Planifikim i mirintegruar dhe efikas
Komponenti 2.1 Zhvillimi i politikave dhe qeverisje e integruar strategjike
Komponenti 2.2 Programi buxhetor afatmesëm
Komponenti 2.3 Planifikimi dhe mbikëqyrja e investimeve publike
Komponenti 2.4 MFP-ja në qeverinë vendore
Objektivi specifik 3. Mbledhja e të ardhurave
Komponenti 3.1 Administrimi tatimor
Komponenti 3.2 Kadastra fiskale e pronave
Komponenti 3.3 Menaxhimi doganor
Objektivi specifik 4. Ekzekutim efikas i buxhetit
Komponenti 4.1 Zgjerimi i përdorimit të SIFQ-së
Komponenti 4.2 Kontrolli i angazhimeve shumëvjeçare dhe i detyrimeve
Komponenti 4.3 Menaxhimi i borxhit dhe i likuiditetit
Komponenti 4.4 Prokurimi publik
Komponenti 4.5 Menaxhimi i fondeve të jashtme
Komponenti 4.6 Forcimi i rolit të ndihmës shtetërore
Objektivi specifik 5. Transparenca e financave publike
Komponenti 5.1 Llogaritë kombëtare të qeverisë
Komponenti 5.2 Monitorimi dhe raportimi financiar dhe i performancës

Komponenti 5.3 Angazhimi i qytetarëve
Komponenti 5.4 Kontabiliteti
Komponenti 5.5 Përmirësimi i menaxhimit të aktiveve
Objektivi specifik 6. Kontrolli i brendshëm efektiv
Komponenti 6.1 Menaxhimi financiar dhe kontrolli në të gjitha institucionet publike
Komponenti 6.2 Auditimi i brendshëm
Komponenti 6.3 Inspektimi financiar publik
Objektivi specifik 7. Mbikëqyrje e jashtme efektive e financave publike
Komponenti 7.1 Auditimi i jashtëm
Kapitulli 3. Qeverisja dhe koordinimi
3.1 Komiteti drejtues për reformën e MFP-së
3.2 Komiteti teknik për reformën e MFP-së
3.3 Drejtoria e reformave në fushën e MFP-së
3.4 Komitetet e koordinimit të objektivave specifikë të strategjisë
3.5 Koordinatorët e objektivave specifikë
3.6 Koordinatorët e komponentëve
3.7 Partnerët e jashtëm
3.8 Koordinimi i reformave të TI-së
Kapitulli 4. Vlerësimi i kostove dhe financimi
Kapitulli 5. Përmbledhje e planit të veprimit të strategjisë së MFP-së
Kapitulli 6. Risqet dhe plani i zvogëlimit të tyre

KAPITULLI 1
HYRJA DHE HISTORIKU

1.1 Synimi dhe organizimi i Strategjisë së MFP-së

Ky dokument është Strategjia e rishikuar e Menaxhimit të Financave Publike (MFP) mbi reformat që ka ndërmarrë QSH-ja për periudhën 2019–2022. Zëvendëson strategjinë e shkuar të periudhës 2014–2020, e bazuar në Raportin e Rishikimit Afatmesëm të Strategjisë, të vitit 2018, proces i cili u drejtua nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE).[2] Në mënyrë që të shtyhej pas vitit 2020, Asistenca e Instrumentit për Paraanëtarësim, MFE-ja shtyu Planin e veprimit dhe Strategjinë deri në vitin 2022.

Strategjia e rishikuar ndihmon kështu QSH-në të përfshijë në të masat e reja që kanë dalë që prej vitit 2014, në mënyrë që ato të trajtohen efektivisht. Qëllimi i Strategjisë së rishikuar 2019–2022, është të konsolidojë mësimet e nxjerra, produktet dhe rezultatet, si dhe ndryshimet për të cilat është rënë dakord pas Rishikimit Afatmesëm gjithëpërfshirës (RA), si dhe të shërbejë si një kuadër e udhërrëfyes që do të ndihmojë për zbatimin më të mirë të rezultateve të MFP-së deri në muajin dhjetor 2022.

Megjithëse në strategji janë pasqyruar ndryshimet, është ruajtur baza me të njëjtin vizion dhe objektiv të përgjithshëm:

Kutia 1.1 Vizioni dhe objektivi i përgjithshëm i Strategjisë së reformës së MFP-së

Vizioni i Strategjisë së reformës së MFP-së *është garantimi i një sistemi të financave publike që nxit transparencën, llogaridhënien, disiplinën fiskale dhe efikasitetin në menaxhimin dhe përdorimin e burimeve publike për ofrimin e shërbimeve të përmirësuara dhe zhvillimin ekonomik.*

Objektivi i përgjithshëm i Strategjisë *është që të mundësojë një buxhet më të mirëbalancuar dhe të qëndrueshëm, me një raport të ulur të borxhit, nëpërmjet kontrollit dhe menaxhimit më të fortë financiar, si dhe me anë të proceseve audituese dhe ku zbatimi i buxhetit është i lidhur siç duhet me politikat e qeverisë.*

Në fund të periudhës së zbatimit të saj, qeveria synon të ketë përmbushur rezultatet kyçe, si më poshtë:

[2] http://financa.gov.al/strategjia-permenaxhimin-e-financave-publike-2014-2020/

- kuadër të matur makroekonomik dhe politika fiskale, me qëllim uljen e borxhit ndaj PBB-së në planin afatmesëm deri në 60 për qind;
- harmonizim të mëtejshëm me dokumentet kryesore të qeverisë, si SKZHI[3], strategjitë sektoriale dhe PBA-të dhe përmirësim të procesit të buxhetit vjetor dhe PBA-së, në mënyrë që të rritet besueshmëria dhe të minimizohen detyrimet e prapambetura;
- përmirësim i mbikëqyrjes së menaxhimit të investimeve publike (MIP);
- përmirësim të efikasitetit në mbledhjen e të ardhurave, për të pasur më shumë qëndrueshmëri në financimin e buxhetit në nivelet e qeverisë qendrore dhe vendore;
- integrim të plotë të Sistemit të Informacionit për Menaxhimin Financiar Shqiptar (SIMFSH) me sistemet e tjera të MFP-së, duke minimizuar kështu veprimtaritë manuale dhe duke mundësuar më shumë saktësi dhe respektim të afateve kohore të raportimit, për të gjitha veprimtaritë financiare të qeverisë;
- rritje të llogaridhënies dhe të transparencës me anë të raportimit më të mirë financiar dhe jofinanciar, në përputhje me standardet ndërkombëtare;
- një disiplinë, kontroll dhe transparencë më të fortë financiare nëpërmjet përmirësimit të auditimit të brendshëm dhe MFK-së në nivelet e qeverisë qendrore dhe vendore;
- rritje të kapaciteteve audituese të Kontrollit të Lartë të Shtetit (KLSH), përfshirë auditimet financiare dhe ato të performancës, në mënyrë që të rritet sa më shumë vlera dhe përfitimet e tyre për shoqërinë.

Temat kryesore të Strategjisë tani janë të organizuara në shtatë objektiva specifikë, në vend të shtyllave, pas udhëzimit të zyrës së Kryeministrit (ZKM), në lidhje me përputhjen e standardeve dhe formateve të IPSIS-së për zhvillimin e kornizës strategjike, të lëshuar në datën 13.5.2019. Ekziston një objektiv i veçantë specifik, i veçantë, në lidhje me mbledhjen e të ardhurave vendëse si rezultat i gjetjeve të MTR-së. Këta të shtatë përfaqësojnë dhe fushat kryesore prioritare:

Objektivi specifik 1. Kuadër fiskal i qëndrueshëm dhe i matur;
Objektivi specifik 2. Planifikim i mirintegruar dhe efikas;
Objektivi specifik 3. Mbledhja e të ardhurave;
Objektivi specifik 4. Zbatim efikas i buxhetit;
Objektivi specifik 5. Transparencë e financave publike;
Objektivi specifik 6. Kontroll i brendshëm efektiv;
Objektivi specifik 7. Mbikëqyrje e jashtme efektive e financave publike.

Strategjia e rishikuar përmban një kapitull mbi objektivat dhe produktet kryesore të politikës (kapitulli 2), qeverisjen dhe koordinimin (kapitulli 3), ka anekse të posaçme për Planin e Veprimit të Reformës dhe Kuadrin me Rezultatet e Strategjisë, që zëvendëson Kuadrin e Rezultateve të versionit të mëparshëm.

1.2 Qëllimi dhe menaxhimi i Strategjisë së MFP-së

Strategjia shërben si një kuadër që do të udhëheqë zbatimin të gjithë reformave të QSH-së për MFP-në deri në fund të vitit 2022. Për të mbajtur siç duhet në kontroll dhe në fokus prioritetet, modifikimet në këtë Strategji, deri në fund të periudhës së zbatimit të saj, do të jenë të kufizuara. Megjithëse Strategjia mbetet e pandryshueshme, plani i veprimit dhe kuadri i rezultateve do të jenë më fleksibël dhe do të rishikohen çdo vit, sipas nevojës dhe, rrjedhimisht, me zbatimin e saj mund të ndryshojnë dhe masat e produktet. Organizimi i Strategjisë dhe mënyra e menaxhimit të saj gjenden në kapitullin 3.

Pas shqyrtimit dhe miratimit nga KD-ja, pronësia e kësaj Strategjie dhe zbatimi i saj i mbeten Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, si udhëheqëse e reformave të MFP-së dhe kryetare e Komitetit Drejtues të MFP-së. Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë është përgjegjës për shpërndarjen, monitorimin dhe ndjekjen e saj.

1.3 Konteksti dhe historiku

1.3.1 Konteksti ekonomik dhe fiskal

[3] Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI II), 2014–2020.

Rritja e Shqipërisë tani është më e fortë. PBB-ja ka ndjekur një trend në rritje për pesë vjet radhazi, duke arritur një mesatare prej 4,4% gjatë tre tremujorëve të parë të vitit 2018. Megjithëse rritja ka qenë e përgjithshme, faktori kryesor ishte prodhimi i energjisë elektrike, kjo falë kushteve të favorshme klimatike; rritja vlerësohet të ketë arritur 4,2% në vitin 2018, duke ndihmuar kështu në uljen e papunësisë.

Në vitin 2014, ku borxhi arriti mbi 72% të PBB-së, tavani ligjor prej 60 përqindësh për raportin e borxhit ndaj PBB-së nuk u respektua. Parashikimet sistematike tejet optimiste për PBB-në dhe të ardhurat, krahas mosndryshimit të sjelljes nga niveli drejtues, sollën edhe reduktim të konsiderueshëm të financimit dhe dëmtuan proceset e planifikimit dhe buxhetimit deri në vitin 2014. Prioriteti kryesor për QSH-në, gjatë fazës së parë strategjike, ishte pikërisht përmbysja e këtyre tendencave dhe, në fund të vitit 2018, borxhi publik u reduktua edhe pse me ritme të ngadalta dhe tani vlerësohet në 68,0% të PBB-së (përjashtuar detyrimet e prapambetura që vlerësohet të jenë 1,5 për qind e PBB-së).

Në fillim të vitit 2017, Shqipëria përfundoi me sukses marrëveshjen e Fondit të Zgjeruar me Fondin Monetar Ndërkombëtar (FMN), por mbetet ende për t'u zbatuar programi i rëndësishëm i reformave, si dhe ka ende sfida të konsiderueshme. Në këtë pikë, QSH-ja mbetet e fokusuar në vijimin e reformave strukturore, përfshirë forcimin e zbatimit të ligjit dhe institucioneve ekonomike, heqjen e barrierave ndaj kursimeve dhe investimeve më të mëdha private, si dhe uljen e borxhit publik me ritëm më të shpejtë, duke përmirësuar menaxhimin e investimeve publike dhe zgjerimin e bazës së të ardhurave.

Në kuadër të zbatimit të kësaj Strategjie të MFP-së, objektivat fiskalë përfshijnë uljen e borxhit publik nga 67 për qind në më poshtë se 60 për qind të PBB-së deri në vitin 2022, duke ulur shpenzimet korrente dhe duke stabilizuar të ardhurat tatimore. Pritet që deficiti buxhetor të bjerë në 1,2 për qind të PBB-së në vitin 2021, duke ulur shpenzimet korrente, por në të njëjtën kohë duke ruajtur rritjen e shpenzimeve kapitale me një mesatare prej 5 për qind të PBB-së. Investimet publike pritet të rriten në mbi 6 për qind të PBB-së në vitin 2021, por kjo rritje mund të jetë e vështirë të realizohet, për shkak të dobësive në planifikim dhe menaxhim të shpenzimeve kapitale.

Në të njëjtën kohë, kuadri fiskal përmban politika buxhetore që mbështesin rritjen ekonomike. Investimet publike të qeverisë qendrore, si në planin afatshkurtër dhe atë afatmesëm do të mbeten në një mesatare prej 5 përqindësh të PBB-së, çka është e rëndësishme për të furnizuar kërkesën totale në planin afatshkurtër, si dhe për të mundësuar rritjen në planin afatgjatë dhe afatmesëm.

Është shumë i rëndësishëm vijimi i reformave të MFP-së për të rritur efikasitetin e shpenzimeve buxhetore, si dhe për të krijuar hapësira që të bëhen shpenzime më efikase në planin afatmesëm dhe afatgjatë.

Sidoqoftë, Shqipëria mbetet mjaft e ekspozuar ndaj risqeve nga ngadalësimi potencial i rritjes ekonomike në Evropë, më shumë në partnerët kryesorë të shkëmbimeve tregtare. Një rënie ekonomike në këto shtete mund të sjellë nivele më të ulëta të eksportit, të dërgesave private nga jashtë dhe të investimeve të huaja të drejtpërdrejta (IHD). Për më tepër, kufizimi i pritshëm i kushteve të përgjithshme financiare në rang botëror do të rrisë kostot e Shqipërisë për financime. Në vend, borxhi publik është i lartë, ndërsa kursimet e ulëta kombëtare dhe mungesa e investitorëve të mëdhenj institucionalë shtojnë varësinë në burimet e huaja të financimit. Mbështetja në rritje në partneritetin publik, privat (PPP-të) për projektet infrastrukturore ka sjellë edhe rritjen e detyrimeve të kushtëzuara. Ndër risqet kombëtare përfshihet edhe ndikimi që do të kenë thatësirat në prodhimin e energjisë, duke sjellë kështu rreziqe të konsiderueshme për buxhetin.

1.3.2 Ecuria kryesore prej vitit 2014

Që prej miratimit të Strategjisë së MFP-së, ka pasur progres në një numër fushash, sipas vetëvlerësimit të MFE-së. Në përgjithësi, ecuria e MFP-së ka qenë e kënaqshme deri në fund të vitit 2018, kur ishin përmbushur 29 për qind e masave, 69 për qind ishin në vazhdimësi dhe

vetëm 2 për qind e masave nuk kishin filluar ende. Paragrafët më poshtë përmbajnë arritjet kryesore sipas objektivit specifik (ish-shtyllat) të Strategjisë.

Shtylla 1. Kuadër fiskal i qëndrueshëm dhe i matur. Në legjislacion u parashikuan dispozita që synojnë të trajtojnë parashikimet tejet optimiste dhe të fusin rregulla të reja për borxhin dhe deficitin, me synim arritjen e një raporti të qëndrueshëm të borxhit ndaj PBB-së. Në MFE është krijuar Njësia e Risqeve Fiskale (NjRF), e cila ka përgjegjësinë të analizojë dhe të raportojë risqet fiskale të qeverisë dhe në buxhetin e vitit 2019 u botua deklarata e parë mbi risqet fiskale (DRF).

Shtylla 2. Planifikim dhe buxhetim i mirintegruar dhe efikas i shpenzimeve publike. QSH-ja miratoi SKZHI II (2015–2020), e cila krahas strategjive sektoriale dhe ndërsektoriale, masterplaneve dhe planeve të veprimit, hedh bazat për zhvillimin strategjik të vendit. Ndryshimet në ligjin organik të buxhetit (LOB) forcuan më shumë rolin e parlamentit që të votojë dhe të miratojë tavanet e PBA-së në nivel programi, si dhe t'i bëjë të detyrueshme për tre vjetët e kohëzgjatjes së PBA-së. Gjithashtu, në fillim të vitit 2018 u miratua udhëzimi standard për Përgatitjen e Buxhetit (USPB) që reflekton praktikat më të mira, të njohura ndërkombëtare. Përgjegjësia për mbikëqyrjen dhe monitorimin e MIP-së i kaloi sërish MFE-së dhe tashmë është ngritur një njësi që është plotësuar me personel. Në vitin 2018, doli një udhëzim që përcaktonte kriteret për prioritizimin dhe vlerësimin e projekteve të mëdha kapitale. Ndryshimet në LOB parashikojnë kufizime në koncesione dhe PPP-të, si dhe krijimin e një fondi kontingjent për t'u mbrojtur në rast problemesh në buxhet, si mungesa në të ardhura apo lëvizje të paparashikueshme të normave të interesit. Ligji i ri, i miratuar në vitin 2013, u ndryshua në vitin 2014 dhe 2015 për të krijuar incentiva në disa sektorë të rinj të ekonomisë. Gjithashtu, ndryshimet për të ndaluar propozimet e parregullta ishin parashikuar të miratoheshin nga Kuvendi në mesin e vitit 2019. Së fundmi, që prej vitit 2019, bazuar në udhëzimet për zbatimin e buxhetit, autoritetet kontraktuese në gjithë qeverinë kanë detyrimin t'i japin MFE-së informacion të rregullt dhe sistematik mbi performancën aktuale dhe të ardhshme , të pritshme, të PPP-ve.

Shtylla 3. Ekzekutim efikas i buxhetit. Zgjerimi i sistemit të informacionit për administratën tatimore, i rishikuar, u përfundua në vitin 2017. Informacioni publik për tatim-taksat është thjeshtuar dhe është përmirësuar përmes faqes së internetit, fushatave të ndërgjegjësimit dhe krijimit të një qendre thirrjesh. Kuadri rregullator i Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave (DPD) është plotësisht në përputhje me legjislacionin e BE-së në fushën e procedurave dhe veprimeve doganore. Efikasiteti i ofrimit të shërbimit doganor në pikat e kalimit kufitar është përmirësuar dhe ka pasur progres të konsiderueshëm në futjen e menaxhimit elektronik doganor për të thjeshtuar pajtueshmërinë me procedurat.

Ka qenë më e ngadaltë nga sa ishte parashikuar ecuria për aksesin *online* të institucioneve buxhetore (IB) në Sistemin e Informacionit Financiar Qeveritar (SIFQ), si dhe është në proces shtrirja e SIFQ-në në SIMFSH, përfshirë integrimin me një sërë sistemesh të tjera plotësuese.

Shtylla 4. Raportim qeveritar transparent. Gjatë kësaj periudhe u realizua një analizë e hendeqeve, e cila ka vlerësuar dallimet mes kuadrit rregullator aktual në vendin tonë dhe standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit në fushën e sektorit publik (SNKSP), për të ndihmuar në procesin e kalimit drejt kontabilitetit mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara. Është përmirësuar formati dhe procedurat për raportimin financiar përgjatë vitit, me botimin e shqyrtimit të raportit gjashtëmujor dhe të informacionit mujor mbi shpenzimet e ministrive, si dhe falë të dhënave financiare tremujore nga ana e qeverisë vendore. Për më tepër, tabelat EDP, që prej vitit 2017, i dërgohen rregullisht EUROSTAT-it, dhe vazhdon puna për dërgimin e tabelave të tjera. MFE-ja është ndihmuar nga nisma BOOST, një ndihmë nga Banka Botërore, për të dhënë akses në të dhënat buxhetore dhe për të promovuar proceset e përmirësuara të vendimmarrjes, transparencën dhe llogaridhënien. Duke filluar nga viti 2015, ligji vjetor për buxhetin 2016 [4], ka filluar të formulohet në një mënyrë më transparente dhe gjithëpërfshirëse dhe u publikua "Buxheti me një vështrim" dhe një version thjeshtuar i "Buxhetit për qytetarët".

[4] http://www.financa.gov.al/al/raportime/buxheti/buxheti-ne-vite/buxheti-2016

Shtylla 5. Kontroll i brendshëm efektiv. Rishikimi dhe përmirësimi i ligjit për "Menaxhimin financiar dhe kontrollin", si dhe hartimi i akteve nënligjore në zbatim të tij bënë të mundur përcaktimin më të qartë të rolit dhe përgjegjësive të aktorëve kryesorë në zbatimin e kërkesave për ngritjen e një sistemi efektiv të MFK-së, kryesisht në lidhje me funksionin e koordinatorit të MFK-së dhe koordinatorit të riskut. Për më tepër, nëpërmjet kuadrit të ri ligjor u rishikuan dhe funksionet e Bordit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik. Me miratimin e ligjit, dolën edhe aktet nënligjore në formën e urdhrave, udhëzimeve, si dhe u përgatit një manual, i rishikuar, për MFK-në. Gjatë kësaj periudhe, DH-ja/MFKK-ja ka ofruar një sërë trajnimesh për rritjen e kapaciteteve të nëpunësve/drejtuesve të njësive publike. Gjithashtu, bashkëpunimi me projektin e binjakëzimit bëri të mundur vlerësimin e situatës së sistemit të kontrollit të brendshëm në disa njësi publike dhe përdorimin e praktikave më të mira për zbatimin e instrumenteve të MFK-së. Në vitin 2015 u rishikua edhe ligji për auditimin e brendshëm për ta harmonizuar atë më mirë me standardet ndërkombëtare, duke forcuar pavarësinë e funksionit të auditimit të brendshëm, duke shtrirë funksionin e auditimit të brendshëm në të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme, në mënyrë që të garantohet monitorimi i sistemit të kontrollit të brendshëm, si dhe me qëllimin kryesor të përdorimit me ekonomi, efektivitet dhe efikasitet të fondeve publike. Në zbatim të tij dolën edhe aktet nënligjore që përmbajnë udhëzime shtesë për një sërë çështjesh që ngrihen në ligjin për auditimin e brendshëm, siç janë: Komisioni për Kualifikimin e Audituesve të Brendshëm, krijimi i Komitetit të Auditimit të Brendshëm në subjektet publike dhe kriteret për krijimin e njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik.

Shtylla 6. Mbikëqyrje efektive e financave publike. KLSH-ja miratoi disa standarde të reja ndërkombëtare për institucionet supreme të auditimit, të cilat rezultuan në një zhvendosje nga auditimet e përputhshmërisë në auditimet financiare dhe të performancës (nga 6 për qind e auditimeve financiare më 2015-ën në 28 për qind më 2018-ën). Hapat për të adresuar shqetësimet, në lidhje me zvogëlimin e zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së janë bërë përmes një rregulloreje nga Parlamenti, që synon të sigurojë një mekanizëm më efektiv për monitorimin e përcjelljes së gjetjeve, megjithëse nevojitet punë e mëtejshme.

1.3.3 Mësimet e nxjerra nga raporti i rishikimit afatmesëm (RRA)

RRA-ja analizoi progresin dhe formulimin e reformave në përgjithësi dhe të ndara për secilën shtyllë. Mësimet më të detajuara të nxjerra nga zbatimi i strategjisë gjenden të shpjeguara nën secilën prej shtyllave (ose, ndryshe, objektivi specifik në kapitullin 2). Megjithatë, disa mësime vlejnë në përgjithësi për strategjinë në tërësi dhe janë si më poshtë:

- *Koordinimi i monitorimit* ndërmjet grupeve të ndryshme të interesit, brenda secilës shtyllë, nuk ishte efektiv: Edhe pse ishte bërë progres i konsiderueshëm, përsëri efektiviteti dhe efikasiteti nuk kanë qenë në maksimum. Monitorimi dhe raportimi mbi arritjet dhe sfidat gjatë zbatimit të Strategjisë ishte i ngushtë dhe i fokusuar vetëm në ecurinë e komponentëve individualë në vend që të fokusohej te shtylla si e tërë. Gjithashtu, ndonjëherë ka qenë e vështirë që të përcaktohej saktë nëse masat ishin plotësuar në kohë apo me vonesë. Ia vlen të theksohet, se, në përgjithësi, shtyllat janë zbatuar sipas planit, por shtylla 1 dhe shtylla 6, në veçanti, i kishin plotësuar masat në mënyrë të konsiderueshme.

- *Vonesat në miratimin e legjislacionit dhe rregulloreve të nevojshme* sollën zbatimin, në një kohë të mëvonshme nga sa pritej, të disa prej masave kryesore të strategjisë, për shembull, ndryshimet në LOB zgjatën rreth një vit më shumë nga periudha e planifikuar, që rrjedhimisht do të thotë se pati vonesa edhe në realizimin e masave të shtyllës 1, që lidheshin me rregullat fiskale, parashikimet dhe kuadrin e përgjegjësisë fiskale.

- *Riorganizimi i ministrive gjatë periudhës së zbatimit* shkaktoi ndërprerje dhe vonesa të paparashikuara në përmbushjen e rezultateve, për shembull, shkrirja e ministrive përgjegjëse për financat dhe për ekonominë në një ministri të vetme, solli ndërprerje të aktiviteteve dhe masave për përmbushjen e rezultateve kyçe në përmirësimin e MIP-së. Vonesa pësuan edhe masat në shtyllën 3 për ekzekutimin e buxhetit që lidhen me shtrirjen dhe integrimin e SIFQ-së. Personelit kyç iu kërkua të fokusohej më shumë në aktivitetet kryesore për t'u siguruar se sistemi të ishte

konfiguruar për të reflektuar strukturat e reja organizative, se sa në përgatitjen e aktiviteteve që lidhen me integrimin dhe shtrirjen e tij.

- *Punësimi dhe mbajtja e personelit të aftë është problem në disa fusha të rëndësishme,* si menaxhimi i borxhit dhe MIP-së. Kjo është, veçanërisht, kritike për ato pozicione për të cilat ka treg edhe në sektorin privat, sidomos për personelin që ka edhe njohuri për TI-në dhe në menaxhimin e borxhit. Megjithëse janë forcuar kapacitetet dhe qenë planifikuar trajnime në shumë komponentë të tjerë, është e pashmangshme që kjo gjë të kërkojë kohë dhe kështu, nuk janë konstatuar rezultate për periudhën 2014–2018.

1.3.4 Vlerësimi i jashtëm

Në RRA u reflektuan gjetjet nga vlerësimet e jashtme, të cilat janë përmbledhur si më poshtë:

Shpenzimet publike dhe përgjegjshmëria financiare

Vlerësimi i shpenzimeve publike dhe përgjegjshmërisë financiare (SHPPF) të vitit 2017 ishte vlerësimi i tretë i MFP-së për Shqipërinë.[5] Nëse krahasohet performanca në përgjithësi, në nivel treguesish, mes këtij vlerësimi dhe vlerësimit të fundit që u krye në vitin 2011, vërehet se nuk ka ndryshime në performancë për asnjë nga të gjashtëmbëdhjetë treguesit. Në rastin e pesë treguesve, ka përmirësim të performancës. Përmirësime u konstatuan në: i. në parashikimin e të ardhurave më realiste; ii. nivelin dhe monitorimin e pagesave të detyrimeve të prapambetura të shpenzimeve: ka pasur më shumë theks në menaxhimin dhe raportimin e angazhimeve dhe detyrimeve të prapambetura të shpenzimeve, e cila ka sjellë përmirësim të performancës; iii. paketat buxhetore përmbajnë më shumë dokumentacion kyç dhe publikut i vihet në dispozicion informacion fiskal i rëndësishëm, si dhe iv. përmirësime në aksesin publik për të përfunduar në mënyrë të besueshme dhe në kohë informacionin mbi prokurimet.

Nga ana tjetër, u konstatua rënie performance, në: i. shkallën e operacioneve të paraportuara, për shkak të mbledhjes së të dhënave më pak gjithëpërfshirëse nga njësitë ekstrabuxhetore; ii. transparencën e transfertave fiskale ndërqeveritare, për shkak të rritjes së pjesës së buxhetit që caktohet për fondet e pakushtëzuara; iii. strukturimin dhe pjesëmarrjen në proceset vjetore buxhetore: performancë më e dobët, për shkak të nxjerrjes së tavaneve buxhetore pas ciklit të buxhetit në vitin 2016 dhe miratimin me vonesë të buxhetit të vitit 2014; dhe iv. shqyrtim më të dobët legjislativ të raporteve të auditimit të jashtëm, për shkak të masave të pakta që morën ministritë e linjës (ML), për të trajtuar rekomandimet që dolën nga raportet e auditimit.

OBZHE, MPQM

Mbështetja për përmirësimin e qeverisjes dhe menaxhimit (MPQM, ang. SIGMA), një nismë e përbashkët e Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OBZHE) dhe e BE-së, përgatiti një vlerësim dyvjeçar mbi zhvillimin e menaxhimit të sektorit publik në Shqipëri. Gjetjet për MFP-në në raportin e vlerësimit për vitin 2017[6], janë:

- Kuadri Buxhetor Afatmesëm vazhdon të mbetet i paqëndrueshëm. Megjithatë, po bëhen përpjekje për të forcuar rolin në proceset buxhetore, me anë të parashikimit të rregullave fiskale në legjislacion, si dhe janë hedhur hapa për të futur një parashikim makro, të pavarur, si dhe tavane afatmesme të detyrueshme për përdoruesit e buxhetit. Vazhdon të jetë i lartë risku i qëndrueshmërisë së financave publike, për shkak të mospasjes së mekanizmave për detyrimin e zbatimit të rregullave fiskale.

- Ka harmonizim mes PBA-së dhe procesit vjetor buxhetor, por duhet më shumë punë për të garantuar përputhshmëri të plotë midis të dyjave. Ka pasur progres për sa i përket transparencës së kërkesave buxhetore, si dhe në qëndrueshmërinë e të ardhurave të planifikuara dhe shpenzimeve në buxhetin vjetor. Megjithatë, ka ende dobësi të konsiderueshme që lidhen me shqyrtimin e buxhetit nga ana e parlamentit.

- Janë miratuar ndryshimet më të fundit ligjore që synojnë fuqizimin e qëndrueshmërisë së borxhit dhe minimizimin e risqeve, që ndikojnë në qëndrueshmërinë e borxhit. Megjithëse

---

[5] https://pefa.org/sites/default/files/AL-Dec17-PFMPR-Public%20ëith%20PEFA%20Check-ENG.PDF

[6] http://www.sigmaweb.org/publications/Monitoring-Report-2017-Albania.pdf#page=124&zoom=100,0,105

qeveria planifikon të ulë gradualisht nivelet e borxhit, ka ende risqe që lidhen me rifinancimin, normat e interesit dhe kursin e këmbimit.

- Detyrimet e reja ligjore kanë ndihmuar për një raportim më të mirë buxhetor gjatë vitit dhe atij vjetor. Sidoqoftë, progresi për transparencën e shpenzimeve ka qenë i kufizuar, pasi analiza publike e shpenzimeve nga ana e institucioneve mbetet e kufizuar. Mundësia e parlamentit për të shqyrtuar raportet vjetore është e kufizuar, pasi ka dobësi në formatin dhe në përmbajtjen e dokumentit.

- MFE-ja kontrollon në mënyrë të qendërzuar disbursimin e fondeve dhe garanton likuiditetin monetar, por mbetet i dobët menaxhimi i likuiditetit dhe duhet të forcohet më shumë kontrolli i angazhimeve.

- Zhvillimi i MFK-së, në nivel organizativ, ende nuk është në të njëjtën fazë si në kuadrin e përgjithshëm ligjor, sepse ka ende nevojë të përmirësohen çështje të rëndësishme, si llogaridhënia menaxheriale dhe delegimi i autoritetit për të realizuar menaxhim efektiv dhe efikas të fondeve publike. Megjithatë, ka pasur përmirësime në disa fusha, si zbatimi në praktikë i disa instrumenteve të MFK-së, si hartat/manualet e proceseve të punës dhe regjistrat e riskut.

- Aktualisht, ekziston një kuadër më i fortë ligjor dhe operacional për auditimin e brendshëm (AB), por ka ende mangësi, pasi disa organizata nuk kanë krijuar ende njësitë AB dhe nuk kanë personel të mjaftueshëm.

- Procesi i prokurimit, në përgjithësi, është tejet i rregulluar dhe kuadri ligjor është shumë përshkrues dhe tepër i ngushtë. Fokusi te kontrollet, sanksionet dhe frika nga ankesat ka krijuar një kulturë frike ndaj riskut në administratën publike që ushqen më shumë pajtimin me rregullat në vend që të fokusohet në performancë dhe në rezultate. Transparencës, integritetit dhe konkurrencës, edhe pse në thelb janë të nevojshme, u është dhënë më shumë prioritet se ç'duhet, siç ilustrohet nga rregullat për blerjet me vlerë të ulët.

- Aktivitetet audituese të KLSH-së ende nuk janë në përputhje me SNISA dhe baza e punës audituese vazhdon të mbetet auditimi i përputhshmërisë, që e vendos theksin më shumë në evidentimin e dëmeve ekonomike, se sa në parandalimin e tyre. Fokusi i KLSH-së në nxjerrjen e sa më shumë raporteve vjetore ndikon negativisht në cilësinë e punës audituese dhe në cilësinë e rekomandimeve.

Raporti i Komisionit Evropian 2019 për Shqipërinë[7]

Raporti përmbledh si më poshtë ecurinë e reformës MFP:

"MFE, e cila udhëheq reformën e menaxhimit të financave publike, iu nënshtrua ristrukturimit në vitin 2018. Aktualisht, ka ende vende vakante në ministri. Për momentin po rivlerësohen prioritetet bazuar në rishikimin afatmesëm të strategjisë MFP 2018. Qëllimi i këtij rivlerësimi është: të përmirësojë planifikimin dhe menaxhimin buxhetor; të forcojë zbatimin e kontrollit të brendshëm në gjithë qeverinë; të parandalojë detyrimet e prapambetura në nivel qendror dhe vendor; të zbatojë rekomandimet e auditimit të brendshëm dhe të jashtëm; të përmirësojë planifikimin dhe menaxhimin e investimeve; përmirësimin e prokurimit publik dhe përputhshmërinë me rregullat e prokurimit; t'u japë më shumë akses *online* institucioneve të thesari; dhe të analizojë risqet fiskale të ndërmarrjeve shtetërore (NSH). Ka pasur progres në përgatitjen e buxheteve për vitin 2018 dhe 2019, në përputhje me LOB, të rishikuar. Është përmirësuar respektimi i rregullave fiskale, falë përfshirjes së një seksioni mbi risqet fiskale dhe një liste për PPP-në në propozimet buxhetore të vitit 2019. Në muajin mars 2018 u miratuan udhëzimet e reja për MIP-në. U ndërmor një fushatë për të luftuar ekonominë informale dhe u pilotuan manualet për auditimin e jashtëm. (Shihni edhe kapitujt 5, 16 dhe 32.) U përmirësua transparenca buxhetore falë botimit në kohë të të gjitha dokumenteve kryesore buxhetore. Janë botuar buxheti i vitit 2019, buxheti për qytetarët dhe një listë e investimeve publike (përfshirë PPP-të në kuadër të programit buxhetor afatmesëm). Duhet të forcohet më tej pjesëmarrja e publikut në proceset buxhetore. U botua raporti për zbatimin e buxhetit për vitin 2017,

[7] https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20190529-albania-report.pdf

megjithatë, informacioni në këtë raport mbi aktivet shtetërore, nuk mundëson një krahasim të plotë me buxhetin fillestar."

Fondi Monetar Ndërkombëtar

Vlerësimi i FMN-së është mbështetur në misione të ndryshme të Departamentit të Çështjeve Fiskale për zhvillimin e kapaciteteve, vlerësime të ndryshme[8] dhe diskutimet sipas nenit IV.[9] Këshillat kanë të bëjnë me shqetësimet që lindin nga rritja e detyrimeve të prapambetura të qeverisë që prej vitit 2016, të cilat lidhen kryesisht me rimbursimin e tatimit mbi vlerën e shtuar (TVSH), pagesat e qeverisë qendrore dhe të qeverisë vendore (QV) për ndërtimin e rrugëve. Është e nevojshme të forcohet parandalimi dhe kontrolli i detyrimeve të prapambetura, parashikimi i të ardhurave (përfshirë rimbursimin e TVSH-së) dhe menaxhimi i likuiditetit, si dhe përmirësimi i kontrollit të angazhimeve, sidomos nga autoriteti rrugor.

Është e nevojshme të përmirësohet parashikimi i likuiditetit dhe i menaxhimit të burimeve qeveritare, në mënyrë më të integruar dhe me kosto efikase. Është bërë progres në zgjatjen e maturimit të borxhit publik dhe vijimin e emetimit të bonove tremujore të thesarit (BTH) për të ndihmuar zhvillimin e tregut monetar. Së bashku me mbështetjen e Bankës së Shqipërisë për menaxhimin e likuiditetit, ky rezultoi një mjet i dobishëm financimi.

Duke qenë se Shqipëria ka mungesë të madhe infrastrukturore krahasuar me vendet e rajonit, autoritetet u kanë dhënë përparësi shpenzimeve kapitale, të cilat mbahen në 5 për qind të PBB-së dhe kanë përshpejtuar përdorimin e PPP-ve. Me gjithë progresin e bërë, vlerësimi dhe përzgjedhja e projekteve të investimit vijon të mbetet e copëzuar, në varësi të burimit të financimit të projektit. Do të ndihmonte konsolidimi i proceseve vendimmarrëse dhe forcimi i njësisë për menaxhimin e investimeve publike në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë (duke përfshirë nën të njëjtën kupolë edhe menaxhimin e PPP-ve).

Përfshirja e vlerësimit të riskut fiskal në buxhetet më të fundit është një hap i mirë drejt së ardhmes, i cili ka thelluar dhe zgjeruar mbulimin. Këtu është përfshirë edhe shtrirja e analizës për të mbuluar një gamë më të gjerë risqesh në bilancet e sektorit publik, si dhe një analizë më të hollësishme të detyrimeve të mëdha të kushtëzuara, përfshirë ato të ndërmarrjeve shtetërore, qeverisë vendore dhe atyre të parashikuara në kontratat PPP. Megjithatë, për të rritur besueshmërinë e parashikimeve buxhetore, raporti duhet të përmbajë edhe politikat qeveritare për zvogëlimin e këtyre risqeve.

Rritja e shpejtë e PPP-ve ka sjellë edhe rritje të risqeve fiskale. Një ndër hapat e parë të rëndësishëm, janë ndryshimet e planifikuara në legjislacionin për PPP-të për të zgjeruar rolin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, si "rojtare" të kostove të mundshme fiskale të PPP-ve, megjithatë procesi i PPP-ve duhet të përafrohet me planifikimin, vlerësimin dhe proceset e përzgjedhjes së investimeve publike.

Strategji të tjera të rëndësishme kombëtare

Shumica e komponentëve të Strategjisë së MFP-së zbërthehen në strategji dhe plane veprimesh më të hollësishme, të cilat përgatiten nga sektorët përgjegjës, si për shembull, Strategjia ndërsektoriale kundër korrupsionit dhe strategjia për reformat RAP. Krahas tyre, strategjia plotësohet edhe nga plani i KLSH-së për zhvillimin strategjik, 2018–2022, si dhe strategjia e komunikimit të KLSH-së, për periudhën 2017–2019. Për të qenë sa më gjithëpërfshirës dhe duke pasur parasysh rëndësinë që luan auditimi i jashtëm në MFP, reformat në këtë fushë janë pasqyruar edhe në këtë dokument. Gjithashtu, qeveria planifikon të miratojë një strategji për prokurimet publike, në përputhje me strategjinë e menaxhimit të financave publike. Është zbatuar një strategji biznesi e administratës doganore shqiptare, 2017–2021, ku objektivat kryesorë, janë: mbrojtja e interesave financiarë dhe ekonomikë të Shqipërisë; kontributi në sigurinë dhe mbrojtjen e shoqërisë dhe të lehtësimit të tregtisë; dhe bashkëpunimi në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar me të gjitha palët e interesit. Do të përgatitet një strategji gjithëpërfshirëse e të ardhurave

[8] Shqipëria: Vlerësimi i menaxhimit të investimeve publike. Vlerësimi i transparencës fiskale.

[9] Shqipëri, 2018: Konsultime për nenin IV, "Njoftim për shtyp"; "Raport stafi"; "Deklaratë e drejtorit ekzekutiv për Shqipërinë".

afatmesme, në mënyrë që të jetë realizuar një analizë e thelluar e të ardhurave, impakteve ekonomike dhe shpërndarëse, përpara se të njoftohet çdo ndryshim në taksa. Strategjia ndërsektoriale për decentralizimin dhe pushtetin vendor është rishikuar dhe një nga objektivat e saj është forcimi i financave vendore dhe autonomia fiskale, në përputhje me Strategjinë e MFP-së. Së fundmi, meqë ekziston pjesërisht një kuadër strategjik për Kontrollin e Brendshëm Financiar Publik (KBFP), MFE-ja ka filluar përgatitjen e një politike gjithëpërfshirëse për kontrollin e brendshëm, me theksin në përcaktimin dhe zbatimin e llogaridhënies menaxheriale.

KAPITULLI 2
OBJEKTIVAT SPECIFIKË TË STRATEGJISË DHE NDËRHYRJET

Objektivi specifik 1. Kuadër fiskal i qëndrueshëm dhe i matur

Objektivi i përgjithshëm

Zhvillimi i një kuadri makrofiskal afatmesëm të qëndrueshëm që mbështet përgatitjen e PBA-së.

Objektivi kryesor i qeverisë mbetet përforcimi i kuadrit makrofiskal afatmesëm, duke përmirësuar rregullat procedurale për të eliminuar riskun që rrjedh nga parashikimet sistematike tejet optimiste për PBB-në dhe të ardhurat buxhetore. Gjithashtu, qeveria do të përpiqet të fuqizojë më tej monitorimin dhe menaxhimin e riskut fiskal.

Ecuria që prej vitit 2014

Progresi më i rëndësishëm i kësaj shtylle ka qenë fuqizimi i bazës ligjore, sidomos në lidhje me rregullimin e parimeve fiskale dhe kuadrin që hedh themelet për konsolidimin fiskal. Ka pasur progres në fuqizimin e Institutit të Statistikave (INSTAT); megjithatë, ka pasur edhe devijime gjatë zbatimit të këtij komponenti, sepse përbëhet nga një grupim nënmasash të ndërlikuara, për të cilat nevojitet koordinim efektiv ndërmjet tri institucioneve të ndryshme: Bankës së Shqipërisë, MFE-së dhe INSTAT-it. Një arritje e madhe është krijimi i Njësisë së Riskut Fiskal (NJRF), i cili ka një mandat të qartë për të analizuar dhe monitoruar risqet buxhetore.

Mësimet e nxjerra dhe prioritetet për periudhën 2019–2022

Objektivi për të krijuar një kuadër të qëndrueshëm dhe të matur ka qenë tejet ambicioz dhe reforma nuk u shoqërua me masa dhe objektiva të synuar të mirëpërkufizuar. Nuk ishte e qartë se çfarë masash konkrete duhej të ndërmerrte MFE-ja për të ulur raportin e borxhit me PBB-në, në mënyrë që të arrinte objektivin e parashikuar prej 45 përqindësh deri në vitin 2020.

Menaxhimi i riskut fiskal mbetet detyrë e vështirë për NJRF-në, pasi qeveria është ende e cenueshme nga shoku fiskal dhe kjo vlen edhe për menaxhimin dhe raportimin e risqeve fiskale si aktivitetet kuazifiskale të ndërmarrjeve shtetërore, PPP-ve apo detyrime të tjera specifike të kushtëzuara. Prandaj, do të përgatitet një metodë më ambicioze për konsolidimin fiskal, përfshirë forcimin e monitorimit dhe menaxhimit të risqeve fiskale.

Gjatë fazës pasardhëse, qeveria do të nxisë dhe do të thellojë reformat në këto fusha për të përshpejtuar zbatimin e tyre në përmbushje të objektivave të këtij objektivi specifik. Në tabelën 2.1 më poshtë janë përfshirë fushat konkrete të reformës, megjithatë duhet vënë re se reformat që kanë të bëjnë me llogaritë kombëtare trajtohen në objektivin specifik 5, "Transparenca e financave publike".

Tabela 2.1 Ndërhyrje kyçe dhe rezultatet

Ndërhyrje kyçe/komponentët	Drejton	Rezultati
1.1 Rregullat dhe parashikimi fiskal	**DAMS**	I. Rritet besueshmëria e kuadrit fiskal II. Risqet fiskale identifikohen dhe frenohen më efektivisht
1.2 Menaxhimi i riskut fiskal	**NJRF**	

Komponenti 1.1 Rregullat fiskale dhe parashikimi

Objektivi

Forcimi i rregullave fiskale për të mbështetur konsolidimin dhe qëndrueshmërinë e kuadrit fiskal në planin afatgjatë.

Konteksti

Në muajin qershor 2016, parlamenti miratoi ndryshimet në LOB, ku përfshihej një paketë parimesh dhe rregullash që lidhen më qëndrueshmërinë e borxhit. Një nga arritjet kryesore qe krijimi i rregullave procedurale, të detyrueshme, të krijuara për të reduktuar riskun që lindte nga parashikimet sistematike optimiste e të njëanshme për PBB-në dhe të ardhurat buxhetore. Raporti i borxhit ndaj PBB-së ka kurbë në rënie krahasuar me atë të vitit 2015 (68 për qind, 70 për qind dhe 71 për qind, përkatësisht në 2018-ën, 2017-ën dhe 2016-ën) dhe parashikimet për PBB-në nominale për vitin 2016-ën, 2017-ën dhe 2018-ën, ishin të kujdesshme dhe më të ulëta se parashikimet përkatëse për PBB-në në *World Economic Outlook*.

Megjithatë, vlerësime të ndryshme sugjerojnë se kuadri fiskal ka nevojë të strukturohet rreth një spirancë fiskale më operacionale, si bilanci primar, në vend të raportit të borxhit dhe, që borxhi të vijojë me rënie derisa të arrijë nivelin e 45 për qind të PBB-së, duhet të krijohen udhëzime të tjera operacionale.

Gjatë viteve të fundit, planifikimet dhe proceset buxhetore janë minuar nga parashikimet tepër optimiste e sistematike për të ardhurat dhe parashikimet tatimore. Mesatarisht, gjatë dhjetë vjetëve të fundit, performanca ka qenë më e ulët se planifikimi me pothuajse 1,5 për qind të PBB-së.

Produktet

MFE-ja do të vijojë të trajtojë mangësitë në mënyrë që të zhvillohet plotësisht dhe të ruhet kapaciteti për parashikimin makrofiskal. Më konkretisht, do të jenë në fokus:

- Produkti 1.1.1 Forcimi i rregullave fiskale

- Produkti 1.1.2 Rritja e besueshmërisë në parashikimin e të ardhurave

Komponenti 1.2 Menaxhimi i riskut fiskal

Objektivi

Forcimi i mbikëqyrjes financiare dhe menaxhimit të risqeve fiskale.

Konteksti

Gjatë vitit 2016 u krijua NJRF-ja, me mandat analizimin dhe monitorimin e risqeve buxhetore. Kjo njësi hartoi me sukses udhëzimet metodologjike për vlerësimin dhe raportimin e risqeve fiskale/buxhetore dhe, për herë të parë, në vitin 2019, u botua në buxhetin vjetor DRF-ja. Megjithatë, detajimi dhe mbulimi i DRF-së ka nevojë të përmirësohet më tej, duke e thelluar dhe shtrirë më shumë analizën për të mbuluar një gamë më të gjerë risqesh, përfshirë ato të NSH-së, detyrimeve të prapambetura, si dhe të risqeve që rrjedhin nga PPP-të dhe kontratat e koncesioneve me ose pa impakt buxhetor. Së fundmi, për të zvogëluar në mënyrë më efektive risqet fiskale, DRF-ja mund të propozojë masa për zvogëlimin e risqeve të monitoruara.

Produkti

MFE-ja do të vazhdojë të trajtojë mangësitë dhe të thellojë analizën, në mënyrë që mbikëqyrja e risqeve fiskale në qeverinë qendrore të menaxhohen dhe të zvogëlohen siç duhet.

- Produkti 1.2.1 Përmirësimi i DRF-së, duke monitoruar dhe zvogëluar më shumë risqe fiskale, sipas nevojës

Objektivi specifik 2. Planifikim i mirintegruar dhe efikas

Objektivi kryesor

Alokim efektiv dhe i drejtë i fondeve publike, në përputhje me zhvillimin e politikave strategjike sektoriale.

Ecuria që prej vitit 2014

Në vitin 2014, QSH-ja miratoi SKZHI II, 2015–2020, e cila, bashkë me strategjitë sektoriale, strategjitë ndërsektoriale, masterplanet dhe planet e veprimit, formon kuadrin për zhvillimin strategjik të vendit. Kryeministria (KM) ka zbatuar një metodologji të re në pesë ministri, me synimin që të standardizojë procesin e monitorimit dhe të raportimit të strategjive sektoriale.

Gjatë periudhës 2015–2017 u bënë disa ndryshime ligjore, përfshirë ndryshimet e LOB-së që synonin: 1. Të vendosnin parimet që do të zbatohen dhe procedurat që do të ndiqen në përgatitjen, vlerësimin dhe miratimin e projekteve të mëdha të investimeve kapitale; 2. Të forconin mbikëqyrjen e MFE-së mbi NSH-të; dhe 3. Të vendosnin disa kufizime mbi alokimet

buxhetore gjatë vitit të parë të zbatimit të angazhimeve shumëvjeçare. Për më tepër, u bënë edhe ndryshimet strukturore, si: ringritja e Drejtorisë për Menaxhimin e Investimeve Publike (MIP) në MFE, e cila konsiderohej e rëndësishme, pasi është një mundësi e mirë për të forcuar rolin e "rojtarit" fiskal, kur bëhet fjalë për vlerësimet e projekteve. Gjithashtu, ndryshimet në LOB fuqizuan rolin e parlamentit për të votuar dhe për të miratuar tavanet e PBA-së në nivel programi dhe për t'i bërë ato të detyrueshme përgjatë gjithë periudhës trevjeçare të PBA-së. Gjithashtu, dolën udhëzime standarde për përgatitjen e buxhetit, ku ndryshimet reflektojnë praktikat më të mira të njohura ndërkombëtare.

Në lidhje me MFP-në në QV, kuadri rregullator ka pasur arritje të mëdha, si miratimi i ligjit "Për vetëqeverisjen vendore", i ligjit "Për financat e vetëqeverisjen vendore" dhe i disa akteve nënligjore dhe udhëzime. Janë kryer shumë trajnime dhe seminare me përfaqësues të qeverisë qendrore dhe vendore për të ndihmuar përdoruesit që të zbatojnë kuadrin e ri ligjor. DFV-ja, në MFE, ka krijuar edhe një bazë të dhënash për planifikimin financiar afatmesëm (PFA) për QV-në.

Mësimet e nxjerra dhe prioritetet për periudhën 2019–2022

Ka nevojë për më shumë punë për të përmirësuar dhe për të seleksionuar dokumentet ekzistuese të planifikimit, si dhe të garantohet, se plane të tjera, si SKZHI, strategjitë sektoriale dhe PBA-të të jenë plotësisht të harmonizuara me njëri-tjetrin. Prandaj, fokusi i objektivit specifik 2 mbetet forcimi i koordinimit ndërmjet njësive të ndryshme qeveritare, të ngarkuara me procesin e planifikimit, monitorimit dhe raportimit.

Objektivi për komponentin 2.3. PBA-ja ishte formuluar mirë, por sërish mungonte lidhja e duhur me SKZHI-në, strategjitë sektoriale dhe PBA-në. Ndryshimet ligjore në vetvete nuk konsiderohen gjithëpërfshirëse mjaftueshëm për ta përmirësuar procesin ekzistues, i cili duhet të rrisë fokusin e politikave, besueshmërinë dhe orientimin drejt rezultateve. Janë përgatitur në periudhën 2017–2018 standardet dhe udhëzimet e reja për PBA-në dhe janë vënë re përmirësime konkrete në proceset dhe cilësinë e dokumentit të PBA-së. Ka ende nevojë për përmirësime, pasi fokusi strategjik pengohet nga vëmendja e kufizuar që i kushton parlamenti procesit të shqyrtimit të PBA-së.

Së fundmi, shumica e masave të planifikuara lidheshin me ndryshimet ligjore dhe sistematike dhe mungojnë, në përgjithësi, masat mbështetëse që janë të nevojshme për t'i vënë në zbatim këto dispozita. Përgatitja e manualeve dhe procedurave dhe kryerja e trajnimeve dhe aktivitetet për ngritjen e kapaciteteve duhej të ishin përfshirë në shtyllë, pasi ishin parashikuar si ndryshime të rëndësishme të procesit.

Përgjatë fazës pasardhëse, qeveria do të nxisë dhe do të thellojë reformat në fushën e planifikimit dhe të buxhetimit për të përshpejtuar zbatimin në përmbushje të objektivave. Në tabelën 2.2, më poshtë, janë përfshirë fushat specifike të reformës.

Tabela 2.2 Ndërhyrjet kryesore dhe rezultatet

Ndërhyrjet kryesore/komponentët	Drejton	Rezultatet
2.1 Zhvillimi i politikave dhe qeverisje strategjike e integruar	**KM**	III. Dokumentet planifikues të qeverisë, si SKZHI-ja, strategjitë sektoriale dhe PBA-ja janë në një linjë dhe plotësisht të harmonizuar me njëri-tjetrin. IV. Buxheti vjetor dhe procesi i PBA-së përmirësohen për të rritur besueshmërinë. dhe plotësinë në planifikimin afatmesëm. V. Përmirësohet mbikëqyrja e menaxhimit të investimeve publike. VI. Fuqizohet menaxhimi financiar në qeverisjen vendore.
2.2 Plani buxhetor afatmesëm	**DAPB**	
2.3 Planifikimi dhe mbikëqyrja e investimeve publike	**DMIP**	
2.4 MFP-ja në qeverisjen vendore	**DFV**	

Komponenti 2.1 Zhvillimi i politikave dhe qeverisje e integruar strategjike

Objektivi

Një proces i rivendosur dhe më i fortë për zhvillimin dhe rishikimin e politikave strategjike sektoriale.

Konteksti

Duhet të përmirësohet cilësia e procesit të rishikimit të strategjive, prioriteteve të politikave dhe kërkesave të PBA-së që përgatisin ML-të. Këtu përfshihet edhe rritja e përputhshmërisë me prioritetet e politikave, përfshirë kërkesat e Kryeministrisë për planifikimin e kuadrit strategjik; integrimin e planeve të kostuara sektoriale të ML-ve brenda PBA-së. Do të përgatitet një raport-progres afatmesëm për SKZHI-në, përfshirë analizën e progresit që kanë bërë strategjitë sektoriale, si dhe raporte mbi performancën, përfshirë pasaportën e indikatorëve dhe integrimin në PBA. Do të zbatohet një sistem gjithëpërfshirës, i automatizuar për të forcuar sistemin e planifikimit të integruar (SPI), i cili lidh planifikimin e politikave strategjike me planifikimin e buxhetit dhe menaxhimin financiar publik. Duhet të forcohet më shumë kuadri që lehtëson proceset që shërbejnë për analizimin dhe për vlerësimin e politikave që bazohen në evidenca. Kërkohet që të zbatohet edhe ngritja e kapaciteteve dhe të menaxhohet sistemi IPSIS.

Produktet

QSH-ja do të vazhdojë që të trajtojë këto mangësi, në mënyrë që të krijohet një proces i rregullt dhe i fortë për zhvillimin e politikave strategjike sektoriale.

- Produkti 2.1.1 Përmirësimi i procesit për rishikimin e cilësisë për strategjitë, prioritetet e politikave dhe kërkesat e PBA-së

- Produkti 2.1.2 Koordinimi i aktiviteteve për menaxhimin e strategjive sektoriale dhe ndërsektoriale

- Produkti 2.1.3 Zbatimi efektiv i SPI-së

- Produkti 2.1.4 Forcimi i procesit për zhvillimin e politikave bazuar në të dhëna dhe

- Produkti 2.1.5 Menaxhimi dhe zbatimi efektiv i sistemi IPSIS

Komponenti 2.2 Programi buxhetor afatmesëm

Objektivi

Kuadër procedural i rreptë dhe i matur për përgatitjen e PBA-së që përfshin prioritetet strategjike të SKZHI-së dhe të sektorëve për periudhën afatmesme dhe realizon rezultatet e pritshme brenda burimeve të qëndrueshme financiare.

Konteksti

Vazhdon të mbetet sfidë rritja e qëndrueshmërisë së programit të buxhetit afatmesëm, si dhe e qëndrueshmërisë së buxhetit vjetor. Gjatë fazës së fillimit, projekti i asistencës teknike (AT) për MFP-në[10], i financuar nga BE-ja, konstatoi shumë mangësi në procesin e PBA-së. Me mbështetjen e projektit, u trajtuan disa prej këtyre mangësive, si për shembull, u miratuan një metodologji e re për përgatitjen e PBA-së, si dhe udhëzime të reja për përgatitjen e buxhetit. Këto ndryshime rregullatore ndihmuan në forcimin e kapacitetit të PBA-së, në formulimin dhe në përgatitjen e buxhetit, por ka nevojë për punë që të forcohet roli orientues që luan dokumentit i PBA-së, si dhe në drejtim të cilësisë së përgatitjes së buxhetit gjatë fazës strategjike. Krahas kësaj, rishikimi i kërkesave buxhetore nxori në pah se ka nevojë të vendoset më shumë theksi në zbatimin e buxhetimit, në bazë të performancës, ku bëhet edhe përcaktimi i qëllimeve strategjike, objektivave dhe treguesve të performancës, si dhe i objektivave të synuar në nivel programi. Është pozitiv fakti se buxhetimi me bazë gjinore (BGJ) në Shqipëri ka ecur me ritëm të shpejtë gjatë pesë vjetëve të fundit. Ndryshimet më të fundit në LOB, në vitin 2016, si dhe ligji për financat vendore që u miratua në vitin 2017, e kanë bërë të detyrueshme për të gjitha institucionet e qeverisë qendrore dhe vendore që të menaxhojnë të gjitha politikat dhe buxhetet, në përputhje të plotë me parimet për barazinë gjinore. Megjithatë, mbeten sfida të konsiderueshme për të zbatuar plotësisht BGJ-në në ciklin e MFP-së, si në nivel qendror dhe vendor.

---

[10] Asistencë teknike e MFP-së për të forcuar aftësinë për të zbatuar strategjinë e MFP-së, duke siguruar koordinim dhe menaxhim më të mirë të procesit të reformës, transparencës dhe procesit të përgjegjësisë përmes dialogut të zgjeruar dhe disponueshmërisë së informacionit përmes Parlamentit.

Produktet

MFE-ja do të vazhdojë të trajtojë këto mangësi në mënyrë që të zbatohet dhe të kuptohet kuadri i rreptë dhe i matur i PBA-së.

- Produkti 2.2.1 Zbatimi i buxhetimit me bazë performancën dhe rritja e përputhshmërisë me metodologjinë e re të sapoprezantuar

- Produkti 2.2.2 Shqyrtimi dhe financimi i nismave për politika të reja

- Produkti 2.2.3 Mbështetja e buxhetit në nivel qendror dhe vendor në barazinë gjinore

- Produkti 2.2.4 Objektivat e politikave dhe TKP-të përkatëse janë pilotuar për t'u përfshirë si një aneks specifik në ligjin vjetor të buxhetit

- Produkti 2.2.5 Përmirësimi i cilësisë dhe i përmbajtjes së dokumenteve buxhetore që shkojnë në parlament për miratim.

Komponenti 2.3 Planifikimi dhe mbikëqyrja e investimeve publike

Objektivi

Procese më të forta dhe kapacitete institucionale për fillimin, për vlerësimin, për caktimin e prioriteteve, si dhe miratimin e të gjitha projekteve të investimeve.

Konteksti

Në vitin 2016[11], FMN-ja kreu një vlerësim për menaxhimin e investimeve publike (VMIP) dhe doli në përfundimin se planet tejet optimiste, strukturimi i papërshtatshëm, copëzimi i tepruar, si dhe kapaciteti relativisht i ulët në menaxhimin e projekteve, kanë kontribuar në moszbatimin efikas të MIP-së. Edhe pse janë ndërmarrë një sërë masash për të trajtuar mangësitë e MIP-së, përfshirë forcimin e dispozitave në LOB, që kufizojnë kostot e PPP-ve dhe kontratave koncesionare në buxhet, krijimin e një njësie të dedikuar për MIP-në, botimin e informacionit të plotë për projektet e miratuara në dokumentet buxhetore, mbetet ende punë për t'u bërë për të forcuar institucionet e MIP-së dhe për të përmirësuar efikasitetin dhe efektivitetin e rezultateve të projekteve të investimeve publike. Shkrirja e Ministrisë së Ekonomisë me Ministrinë e Financave krijoi probleme në bashkërendim për menaxhimin e PPP-ve. Është e nevojshme që kjo të trajtohet në planin afatshkurtër. Shqipëria ka një portofol relativisht të ulët të PPP-ve (vlerësohet të ketë një investim total të barabartë me 36 për qind të PBB-së në vitin 2017), i cili është duke u zgjeruar. Kjo kërkon aftësi më të forta analitike nga ana e agjencive qeveritare dhe MFE-së, për të vlerësuar si duhet raportin kosto-përfitim dhe për të përmirësuar disenjimin dhe mbikëqyrjen e projekteve. Brenda MFE-së, kapaciteti për vlerësimin, monitorimin dhe menaxhimin e projekteve të investimeve publike përfshirë PPP-të, është i copëzuar. Drejtoria për Koncesionet që është në varësi të Drejtorisë së Përgjithshme për Përputhshmërinë dhe Rregulloret dhe Drejtoria e Analizës dhe Programimit Buxhetor (DAPB) dhe NJRF-ja nën varësinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit, përfshihen në etapa të ndryshme për analizimin, monitorimin dhe mbikëqyrjen e PPP-ve. Nga ana tjetër, Drejtoria për Menaxhimin e Investimeve Publike, gjithashtu, në varësi të Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit, nuk është e përfshirë me PPP-të. Aktualisht, në MFE mungon koordinimi efektiv mes zhvillimit të PPP-ve dhe ciklit të përgjithshëm të investimeve publike.

Produktet

Gjatë katër vjetëve të ardhshëm, qeveria do të përqendrohet në zgjerimin e organizimit institucional dhe të kapaciteteve për përzgjedhjen, vlerësimin dhe monitorimin e të gjitha projekteve të investimeve publike përfshirë PPP-të.

- Produkti 2.3.1 Përgatitja dhe mirëmbajtja e listës së unifikuar të projekteve të miratuara, pavarësisht burimit të financimit

- Produkti 2.3.2 Rritja e cilësisë së propozimeve për projektet madhore të investimeve publike që çohen për aprovim

- Produkti 2.3.3 Përmirësimi i monitorimit të investimeve publike përfshirë projektet PPP dhe koncesionet

---

[11] Shqipëria: Vlerësimi për menaxhimin e investimeve publike, qershor 2016: www.imf.org.

Komponenti 2.4 MFP-ja në qeverinë vendore

Objektivi

Menaxhim financiar i matur, efektiv dhe efikas i qeverive vendore.

Konteksti

Njësitë e qeverisjes vendore janë përgjegjëse për një numër funksionesh dhe, financat në qeverinë vendore përfaqësojnë 9,8 për qind të shpenzimeve totale publike. Në të njëjtën kohë, kapacitetet e QV-së për të menaxhuar fondet publike shpesh janë të dobëta, duke sjellë shpenzime joefikase dhe mungesë transparence. Për më tepër, parashikimi i dobët i të ardhurave dhe performanca e dobët për mbledhjen e të ardhurave nga burimet e veta, mungesa e planifikimit në planin afatmesëm dhe afatgjatë, si dhe rritja e detyrimeve të prapambetura, janë fusha të tjera që ngrenë shqetësime të cilat MFE-ja do t'i trajtojë.

Është rishikuar "Strategjia ndërsektoriale për decentralizim dhe qeverisje vendore" (gati për miratim) dhe është harmonizuar me Strategjinë e MFP-së, për shembull, produktet 2.4.1 deri në 2.4.5 janë pjesë edhe e Strategjisë së decentralizimit.

Prandaj, MFE-ja do të përpiqet të garantojë që reformat që ndërmerren në nivel qendror, të kenë probabilitet më të mirë për t'u zbatuar në mënyrë efektive edhe në nivelin vendor.

Produktet

- Produkti 2.4.1 Forcimi i planifikimit strategjik dhe menaxhimi i buxhetit në nivel të qeverisjes vendore

- Produkti 2.4.2 Menaxhim efektiv i të ardhurave

- Produkti 2.4.3 Përmirësimi i sistemit financiar ndërqeveritar të transfertave

- Produkti 2.4.4 Krijimi i kontrollit të brendshëm efektiv dhe funksionit të auditit

- Produkti 2.4.5 Rritja e kapaciteteve të MFE-së për të menaxhuar reformat e MFP-së në nivelin e QV-së

- Produkti 2.4.6 Krijimi, testimi dhe vendosja në funksion e IPSIS për NJQV-të

Objektivi specifik 3. Mbledhja e të ardhurave

Objektivi

Përmirësimi i performancës së qeverisë në mbledhjen të ardhurave.

Vijon forcimi i menaxhimit të të ardhurave nëpërmjet rishikimit të politikave tatimore; rritjes së kapacitetit të administratës tatimore dhe doganore në mbledhjen e të ardhurave; përmirësimit të përmbushjes tatimore të tatimpaguesve; uljes së hendekut tatimor dhe uljes së evazionit fiskal dhe ekonomisë informale.

Ecuria që prej vitit 2014

Sistemi informatik i administratës tatimore është funksional që prej vitit 2015 dhe rishikimet e sistemit përfunduan në vitin 2017. Në vitin 2015, administrata tatimore filloi zbatimin e metodologjisë bashkëkohore të menaxhimit të riskut të përmbushjes (MRP), që synon të përmirësojë përmbushjen tatimore mbi bazë të grupeve të riskut (p.sh., fokusuar në sektorë ekonomikë). Projektet e para të menaxhimit të riskut të përmbushjes filluan në muajin tetor 2015 dhe u përqendruan në sektorët e tregtisë, shëndetësisë dhe turizmit. Administrata tatimore ka qenë objekt i reformave të ndryshme, por ka ende nevojë për përmirësim të kapaciteteve dhe të administrimit të personelit. Informacioni mbi tatimet është thjeshtuar dhe informacioni për tatimpaguesit është përmirësuar përmes faqes së internetit, fushatave të ndërgjegjësimit dhe të ngritjes së një qendre telefonike. Që prej vitit 2017, administrata tatimore ka punuar që të automatizojë procedurat e bazuara në risk për të gjitha rimbursimet e TVSH-së, çka mundëson një menaxhim më të mirë të procesit dhe rrit transparencën për tatimpaguesit.

Është vonuar reforma për taksën mbi pronën, megjithatë është krijuar një strukturë e dedikuar që do të punojë për ngritjen dhe menaxhimin në nivel qendror të sistemit informatik të kadastrës fiskale dhe reformës së taksës së pronës. Gjithashtu, është përgatitur kuadri ligjor për taksën mbi pronën sipas çmimit të referencës.

Kuadri rregullator i DPD-së është plotësisht i harmonizuar me *acquis* të BE-së në fushën e procedurave dhe të operacioneve doganore. Është përmirësuar efikasiteti i shërbimit doganor në pikat e kontrollit kufitar, falë mbështetjes nga programi "Kontrolli i eksporteve dhe siguria

Kombëtare" (KESK), së bashku me donatorë të tjerë dhe institucione ligjzbatuese, si edhe projekte IPA. Është bërë progres i konsiderueshëm për futjen e menaxhimit doganor elektronik për të thjeshtuar procedurat e përputhshmërisë. Është përmirësuar transparenca, me: i. miratimin e rregulloreve për ndjekjen e pretendimeve ligjore dhe rezultatet raportohen në portalin "STOP KORRUPSIONIT"; si dhe ii. ngritjen nga ana e DPD-së së një numri mekanizmash ankimimi, ku operatorët e biznesit mund të apelojnë vendimet. Janë përmirësuar sistemet dhe proceset për të rritur efikasitetin, shembull i të cilave janë: udhëzuesit e thjeshtuar për zbatimin e procedurave doganore, sistemet e kontrollit të sigurisë me profilet e reja dhe të përditësuara të operatorëve, "Strategjia e punës për administratën doganore", kuadri për sektorin privat, si dhe "Baza e të dhënave kombëtare për vlerësimin doganor", që është në përputhje me standardet e Organizatës Botërore të Doganave.

Mësimet e nxjerra dhe prioritetet për periudhën 2019–2022

Volumi i madh i masave dhe mungesa e prioriteteve të ndryshme e ka penguar vendosjen e fokusit tek aspektet më të rëndësishme të reformës. Duke u fokusuar më shumë te masat se sa te produktet, vlerësimi absolut i progresit bëhet i vështirë. Disa prej masave ishin në plan afatgjatë dhe të ndërlikuara, si dhe mbulonin një periudhë katër–pesëvjeçare dhe, kryesisht, janë pikërisht këto masa që kanë pasur vonesa në zbatim. Mungonte rëndësia dhe fushëveprimi i fokusit të masave kundër informalitetit dhe mungonin objektivat konkretë, treguesit, objektivat e synuar dhe produktet.

Së fundmi, automatizimi i doganave mbetet prioritet dhe do të mbështetet në zhvillimin e sistemeve informatike, përfshirë SRTP-në (sistemin e ri të transitit të përbashkët), sistemin e menaxhimit të integruar të tarifave (SMIT) dhe përditësimin e moduleve ekzistuese në sistemin bazë *Asycuda*, si dhe krijimin e moduleve të reja. Fushat specifike të reformave janë përshkruar në tabelën 2.3 më poshtë.

Tabela 2.3 Ndërhyrjet kryesore dhe rezultatet

Ndërhyrjet kryesore/komponentët	Drejton	Rezultate
3.1 Administrimi tatimor	**DPT**	VII. Rriten të ardhurat tatimore VIII. Reduktimi i informalitetit me përmirësimin e vetëdeklarimit dhe rritja e forcës së zbulimit të kontrolleve IX. Kadastra fiskale plotësisht funksionale X. Rriten të ardhurat doganore
3.2 Kadastra fiskale e pronave	**DPTP**	
3.3 Menaxhimi doganor	**DPD**	

Komponenti 3.1 Administrimi tatimor

Objektivi

Menaxhimi efektiv, efikas dhe transparent i të ardhurave tatimore; rritja e efikasitetit në mbledhjen e detyrimeve tatimore, përfshirë taksën mbi pronën.

Konteksti

Fokusi për të ardhmen do të mbetet i pandryshueshëm: të menaxhohen në mënyrë efektive, efikase dhe transparente të ardhurat tatimore. Krahas kësaj, QSH-ja do të përpiqet të rrisë numrin e tatimpaguesve që përmbushin detyrimin ligjor për të paguar tatimet dhe do të rrisë normën e mbledhjes së taksës mbi pronën.

Ka pasur shumë përmirësime në menaxhimin përputhshmëri-risk, në sistemet e teknologjisë së informacionit, strukturat organizative dhe transparencën për tatimpaguesit, nëpërmjet fushatave të ndërgjegjësimit, faqeve të internetit më të thjeshta për përdoruesit dhe qendrave telefonike. Sidoqoftë, mbetën ende hendeqe në zhvillim që duhen trajtuar, të renditura si më poshtë:

- sistemi tatimor është prekur nga ndryshimet e shpeshta *ad hoc* të politikave, të cilat mund të kenë minuar integritetin e sistemit tatimor, dobësuar bazën tatimore dhe vështirësuar mbledhjen e të ardhurave;

- ka pasur vonesa të konsiderueshme në rimbursimin e TVSH-së, dhe janë akumuluar detyrimeve të prapambetura tatimore;

- zbatimi i metodologjisë bashkëkohore të menaxhimit të riskut të përmbushjes ka marrë shumë kohë dhe nuk është bërë ende efektive; kërkohet rritje e përpjekjeve për zbatim;

- roli i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (DPT) duhet të forcohet më tej në mbledhjen e borxhit tatimor; dhe

- regjistri i tatimpaguesve ka nevojë të saktësohet dhe të plotësohet.

Produktet

Prandaj, MFE-ja dhe DPT-ja do të vazhdojnë të trajtojnë mangësitë që të forcohet më shumë funksioni për mbledhjen e të ardhurave, në administratën tatimore.

- Produkti 3.1.1 Miratimi i një strategjie gjithëpërfshirëse afatmesme për mbledhjen e të ardhurave

- Produkti 3.1.2 Krijimi i një procedure të automatizuar bazuar në risk për menaxhimin e rimbursimit të TVSH-së

- Produkti 3.1.3 Kryerja e automatizimit të plotë të proceseve kyçe të administratës tatimore

- Produkti 3.1.4 Plotësimi i menaxhimit të riskut të përmbushjes (përqendrimi do të jetë në segmentet e tatimpaguesve me risk të lartë përmbushjeje, për sa u përket të ardhurave tatimore)

- Produkti 3.1.5 Plotësimi dhe saktësimi i regjistrit të tatimpaguesve

- Produkti 3.1.6 Reduktimi i informalitetit

- Produkti 3.1.7 Përmirësimi i menaxhimit të borxhit tatimor

Komponenti 3.2 Kadastra fiskale e pronave

Objektivi

Krijimi i një kadastre fiskale efektive, ku të konsolidohen të gjitha të dhënat për pronat, si dhe llogariten dhe mblidhen taksat mbi pronën.

Konteksti

Për të krijuar bazën e informacionit për taksën e re mbi pronën, në muajin nëntor 2018 u krijua sistemi i kadastrës fiskale, ku tashmë të gjitha bashkitë kanë akses. Janë në proces zhvillimet e tjera për të përditësuar sistemin informatik. Është hartuar dhe konsultuar me partnerët e jashtëm kuadri ligjor për taksën e pronës bazuar te çmimi i referencës, ndërkohë që është planifikuar të hartohet ligji i bazuar tërësisht te vlera e tregut. Drejtoria e Përgjithshme e Taksës së Pasurisë po bashkëpunon me administratën tatimore të Suedisë, Kosovës dhe të Shqipërisë për të ngritur sistemin e kadastrës fiskale.

Produktet

- **Produkti 3.2.1 Futja në fuqi e taksës mbi pronën, sipas vlerës së zonës mbi ndërtesat dhe mbledhja e saj**

- Produkti 3.2.2 Zbatimi i kadastrës fiskale nga bashkitë

Komponenti 3.3 Menaxhimi doganor

Objektivi

Mbrojtja e interesave financiarë dhe ekonomikë të Shqipërisë, kontributi në sigurinë dhe mbrojtjen e shoqërisë, lehtësimi i tregtisë dhe bashkëpunimi me të gjitha palët përkatëse të interesit në nivel kombëtar ose ndërkombëtar.

Konteksti

Në këtë fushë janë raportuar arritje të rëndësishme që prej vitit 2014, sidomos në përafrimin e kuadrit rregullator të DPD-së me *acquis* të BE-së. Gjithashtu, është përmirësuar ofrimi i shërbimit ndaj klientit falë riprojektimit të shumë proceseve, si procedurat e thjeshtuara dhe futjes së menaxhimit doganor elektronik për të lehtësuar procesin e përmbushjes. Gjithashtu, në muajin maj 2019, në kuadër të marrëveshjes së projektit të binjakëzimit nën IPA 2013, u përfundua legjislacioni për zhvillimet e SRTP-së, në lidhje me ndërveprimin e sistemeve informatike me sistemet SRTP të BE-së. Mbeten ende disa mangësi që nuk mund të trajtoheshin, të tilla si:

- për shkak të mungesës së modulit specifik në sistemin *Asycuda World*, nuk është bërë shumë progres për përdorimin proaktiv të njoftimeve paraprake elektronike për ngarkesat që mund të përbëjnë rrezik të lartë për shkelje;

- ende nuk është krijuar lista me operatorët ekonomikë të autorizuar (OEA);

- është vonuar futja e një garancie të vetme për të gjithë llojet e transaksioneve dhe të regjimeve që është në varësi të ngritjes së sistemit të TI-së;

- nuk është bërë progres në rritjen e kontrollit doganor në brendësi të kufirit tokësor, për tregtarët e dyshimtë;

- edhe pse legjislacioni shqiptar për tarifat është vlerësuar si i harmonizuar me legjislacionin e BE-së, ende nuk janë bërë ndryshimet për të trajtuar dallimet mes tyre;

- gjithashtu, vonesa ka pasur edhe kontraktimi i SMIT-së nga DPD-ja për të qenë në përputhje me procedurat e BE-së.

Produktet

Prandaj, MFE-ja dhe DPD-ja do të vazhdojnë t'i trajtojnë këto mangësi me fokusin si më poshtë:

- Produkti 3.3.1 Rritja e mbledhjes së detyrimeve, duke përmirësuar politikat/procedurat dhe proceset doganore

- Produkti 3.3.2 Zhvillimi dhe mirëmbajtja e një sistemi të plotë për menaxhimin e riskut, në përputhje me modelin e harmonizuar të riskut të BE-së

Objektivi specifik 4. Ekzekutim efikas i buxhetit

Objektivi

Përdorim efikas dhe efektiv i burimeve të aprovuara buxhetore.

Konteksti

Ky objektiv specifik fokusohet në zbatimin sa më efikas të buxhetit, për të garantuar që buxheti, siç aprovohet nga Kuvendi, të zbatohet sipas planit dhe të ketë likuiditet në kohën e duhur, për të shmangur krijimin e detyrimeve të prapambetura dhe për të siguruar një nivel të kënaqshëm likuiditeti. Prandaj, fokusi është te: i. mbajtja në kontroll e shpenzimeve - për të siguruar që pagesat të mos e tejkalojnë buxhetin dhe të mos krijohen detyrime të prapambetura; ii. menaxhimi i likuiditetit dhe i borxhit - për të siguruar që të ketë likuiditet të mjaftueshëm për të bërë pagesat në kohën e duhur dhe me kosto sa më të ulëta, për të garantuar një shkallë të matur risku; iii. përafrimi i sistemit të prokurimit me *acquis* dhe përmirësimi i transparencës dhe i efikasitetit; iv. përmirësimi i sistemit SIMBNJ/listëpagesave dhe ndërfaqes së thesarit për një përllogaritje të plotë të centralizuar dhe pagesa elektronike.

Ecuria që prej vitit 2014

SIFQ-ja është një sistem që shërben për të kontrolluar dhe për të monitoruar të ardhurat dhe shpenzimet dhe plani i qeverisë është të shtrijë sistemin edhe tek IB-të e tjera. Sistemi është baza e ekzekutimit efektiv të buxhetit. Aktualisht, 15 IB janë pjesë e SIFQ-së dhe ato përfaqësojnë rreth 74 për qind të shpenzimeve kundrejt planit fillestar të vitit 2014, për shtrirjen e sistemit në 50 IB deri në vitin 2018. Megjithatë, qysh prej vitit 2016 nuk ka pasur më shtrirje të sistemit në institucione të tjera buxhetore dhe kjo ka ndikuar, si në kontrollin e shpenzimeve dhe të detyrimeve të prapambetura, si dhe në automatizimin e kontrollit të listëpagesave nëpërmjet sistemit informatik për menaxhimin e burimeve njerëzore (SIMBNJ). Sistemi për menaxhimin e listëpagesave, aktualisht mbulon mbi 50 për qind të pagave dhe ka pasur një rritje të konsiderueshme të nivelit bazë prej 0,5 për qind në vitin 2014, por ende mbetet i paplotë, pasi nevojitet kontroll manual dhe rakordim të dhënash[12]. Strategjia parashikonte një sistem për menaxhimin e fondeve të jashtme, sistemi i informacionit të menaxhimit të asistencës së jashtme (SIMAJ): ka përfunduar projektimi i sistemit dhe është duke u kryer struktura dhe migrimi i pjesshëm i të dhënave. Ekziston "Strategjia afatmesme për menaxhimin e borxhit" (SAMB) dhe kryhen rregullisht analiza për qëndrueshmërinë e borxhit. Në vitin 2018 u pilotua "Programi për operatorët e tregut", i cili do të mbulonte më shumë tituj dhe do të përfshinte një numër më të madh të drejtash e detyrimesh, me synimin për të krijuar parametra të titujve, për të filluar me zhvillimin e aktivitetit në tregun dytësor. Është ngritur Komiteti për Menaxhimin e Borxhit dhe Likuiditetit, për të zgjeruar kuadrin operacional dhe për të bashkërenduar menaxhimin e borxhit. Ka nevojë të forcohet më shumë saktësia e parashikimeve të likuiditetit dhe të procedurave për

[12] SHPPF, 2017.

menaxhimin e likuiditetit në Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit (DPTH). SHPPF 2017 raportonte se tepricat në llogaritë bankare jashtë llogarisë unike të thesarit (LLUTH), qenë më të mëdha se teprica e LLUTH-it. Është bërë progres në harmonizimin e ligjit të prokurimeve publike (LPP) me *acquis* të BE-së (direktivën e re të BE-së), si dhe janë marrë masa ligjore dhe rregullatore për të rritur pavarësinë e Komisionit të Prokurimit Publik (KPP). Gjithashtu,, më 16 korrik 2018 ka filluar funksionimin KPP-ja, por duhet bërë më shumë punë në fazën pasardhëse që ky komision të jetë efektiv.

Mësimet e nxjerra dhe prioritetet për periudhën 2019-2020

Shumë prej masave të komponentëve janë plotësuar sipas planit ose janë në proces, por kompleksiteti dhe plani afatgjatë i disa prej masave ka shkaktuar vonesa te këto të fundit. Progresi në disa prej komponentëve është vonuar si pasojë e ristrukturimit të qeverisë dhe institucioneve, për shembull, shtrirja e SIMBNJ-së dhe e SIFQ-së, si dhe aktivitetet nën komponentin e prokurimit publik. Në fushat, si menaxhimi i borxhit, që kërkon aftësi të specializuara, ka qenë i vështirë rekrutimi dhe mbajtja e personelit me aftësitë e duhura, përpos trajnimeve që janë zhvilluar për ta ulur këtë vështirësi. Për shumë vite, struktura e Drejtorisë së Borxhit ka vuajtur nga ndryshimet e shpeshta dhe mungesa e stafit në të gjitha kategoritë, për këtë arsye është prekur negativisht edhe procesi vendimmarrës.

Në fazën pasardhëse, qeveria do të vijojë rritjen e përdorimit të SIFQ-së, si dhe monitorimin e angazhimeve dhe të detyrimeve nëpërmjet sistemit. Në SIFQ janë futur me sukses kontrollet e automatizuara për të parandaluar që IB-të të marrin më shumë angazhime se ç'duhet, për të shmangur krijimin e detyrimeve të reja të prapambetura. Por, po vazhdojnë të krijohen detyrime të reja të prapambetura, pasi këto masa kontrolluese ende nuk janë operacionale dhe nuk ka asnjë sektor në MFE që të sinjalizojë nëse janë hedhur në SIFQ këto tavane trevjeçare. Integrimi i listëpagesave të automatizuara në SIFQ mbetet produkt i paplotësuar dhe do të vazhdojnë përpjekjet për ta realizuar. Një fokus të veçantë do të ketë reformimi i menaxhimit të borxhit dhe likuiditetit në zbatim të rekomandimeve të FMN-së dhe Bankës Botërore. Gjithashtu, prioritet është dhe forcimi i ligjit për prokurimet publike, në përputhje me *acquis*, si dhe krijimi i procedurave të apelimit më efikase dhe transparente nëpërmjet KPP-së. Do të vazhdojë puna për të rritur përputhshmërinë, duke hedhur të dhënat në SIMAJ dhe duke përdorur këtë sistem si burimin kryesor të informacionit për të gjitha fondet që vijnë nga donatorët.

Fushat specifike të reformës janë në tabelën 2.4 më poshtë.

Tabela 2.4 Ndërhyrjet kryesore dhe rezultatet

Ndërhyrjet kryesore/komponentët	Drejton	Rezultate
4.1 Zgjerimi i përdorimit të SIFQ-së	**DPB**	XI. Ekzekutim efikas i buxhetit (me anë të përdorimit të TI-së) XII. Përpunim i automatizuar i ekzekutimit të listëpagesave XIII. Detyrime të prapambetura të minimizuara XIV. Kostot e huamarrjes të ulura dhe ka likuidet në gjendje sa herë është i nevojshëm XV. Efikasitet dhe transparencë e rritur në sistemin e prokurimeve
4.2 Kontrollet e angazhimeve shumëvjeçare dhe llogaritë e pagueshme	**Zëvendësministër dhe SP**	
4.3 Menaxhimi i borxhit dhe i likuiditetit	**DPBPKNH**	
4.4 Prokurimi publik	**APP**	
4.5 Menaxhimi i fondeve të jashtme	**DPBPKNH**	
4.6 Forcimi i rolit të ndihmës shtetërore	**DPZHEP**	

Komponenti 4.1 Zgjerimi i përdorimit të SIFQ-së

Objektivi

Forcimi dhe përsosja e transparencës, efikasitetit dhe unifikimit të zbatimit të rregullave të kontrollit të brendshëm financiar në procesin e zbatimit të buxhetit të shtetit dhe raportimit financiar të qeverisjes së përgjithshme.

Konteksti

Sot, SIFQ-ja përdoret nga pesëmbëdhjetë IB, buxhetet e të cilave përbëjnë përafërsisht 74 për qind të buxhetit të shtetit.

Gjatë fazës së dytë të strategjisë, Thesari do të vijojë shtrirjen e SIFQ-së në IB në qeverisjen qendrore dhe vendore dhe ta integrojë me sisteme të tjera, si: a) doganat, për shkëmbimin ditor të informacionit mbi të ardhurat e mbledhura; b) sistemin shqiptar të prokurimit publik (APP), për informimin në kohë reale për fondet në dispozicion para se të ndërmerren angazhime; c) SIMBNJ-në, për të automatizuar pagesat e pagave të punonjësve publikë në SIFQ.

Produktet

- Produkti 4.1.1 Rritja e përdorimit të drejtpërdrejtë të SIFQ-së nga IB-ja

- Produkti 4.1.2 Integrimi i SIFQ me sistemet e tjera qeveritare të TI-së

Komponenti 4.2 Kontrolli i angazhimeve shumëvjeçare dhe i detyrimeve

Objektivi

Angazhimet afatmesme kontrollohen tërësisht brenda kufijve të caktuar nga qeveria dhe parlamenti, nëpërmjet ligjit për buxhetin dhe ligjeve të tjera përkatëse, rregulloreve dhe udhëzimeve.

Konteksti

Prezantimi i kontrollit të angazhimeve shumëvjeçare ishte një nga masat në "Strategjinë për parandalimin dhe eliminimin e detyrimeve të prapambetura të vitit 2014" dhe shumë masa janë zbatuar me sukses. Në vitin 2015, për të kontrolluar sa më mirë angazhimet shumëvjeçare, ministri i Financave nxori një urdhër[13], ku specifikonte detyrimet shtesë të IB-ve për të regjistruar angazhimet shumëvjeçare. Gjithashtu, në LOB, të ndryshuar, në nenin 40 u shtuan dispozita të reja për të garantuar që angazhimet shumëvjeçare të IB-ve të jenë brenda tavaneve trevjeçare të miratuara me ligjin vjetor të buxhetit. Së fundmi, për të zbatuar këto kontrolle të angazhimeve shumëvjeçare, në vitin 2016, SIFQ-ja u zgjerua dhe përfshiu edhe kontrollet e automatizuara, në mënyrë që të lejonte ndarjet e tyre sipas viteve të veçanta të PBA-së. Qëllimi përfundimtar ishte eliminimi i çdo mundësie për krijimin dhe akumulimin e detyrimeve të reja të prapambetura, që nuk mbuloheshin nga fondet buxhetore përkatëse. Edhe pse janë plotësuar shumë prej masave të nevojshme, raporti i KLSH-së për zbatimin e buxhetit të vitit 2017 thekson se ende mbetet problem zbatimi i këtij urdhri. Prandaj, deri në fund të vitit 2019, nëpërmjet një grupi pune për detyrimet e prapambetura, i cili drejtohet nga zëvendësministri i Financave dhe Ekonomisë dhe nëpunësi i parë autorizues, si dhe me përfaqësues nga DP-ja e Thesarit dhe Drejtoria e Harmonizimit të KBFP-së, MFE-ja do të monitorojë nga afër pajtueshmërinë e njësive buxhetore me rregulloret në fuqi. Rezultatet e monitorimit do të përcaktojnë masat e ardhshme dhe do të shërbejnë si baza për përgatitjen e sanksioneve për rastet e mospërputhshmërisë.

Produkti

MFE-ja do të vazhdojë përpjekjet derisa të përmbushet plotësisht ky objektiv.

- Produkti 4.1.2 Rritja e regjistrimit të angazhimeve dhe të detyrimeve, përfshirë detyrimet e prapambetura

Komponenti 4.3 Menaxhimi i borxhit dhe i likuiditetit

Objektivi

Sigurimi i realizimit të nevojave të qeverisë për financim me kosto sa më të ulët, duke mbajtur nivele të pranueshme të ekspozimit ndaj risqeve, si edhe në përputhje me vlerësimin kreditor të Shqipërisë.

Konteksti

Praktikat aktuale për menaxhimin e likuiditetit janë pasive dhe fokusohen më shumë në zbatimin e buxhetit se sa në menaxhimin e fluksit monetar nëpërmjet LLUTH-it. Qëndrueshmëria e parashikimit në planin afatshkurtër, normalizimi i flukseve monetare apo rritja e efikasitetit dhe efektivitetit të përgjithshëm në procesin për menaxhimin e likuiditetit, nuk konsiderohen si objektiva thelbësorë. Është i nevojshëm përmirësimi i efikasitetit dhe i efektivitetit në menaxhimin e burimeve njerëzore, si dhe reduktimin e kostove që rrjedhin prej tyre, si dhe një integrim më i mirë i menaxhimit të borxhit dhe likuiditetit. Është krijuar një

[13] Urdhri nr. 2, datë 9.1.2015, neni 30.

Komitet për Menaxhimin e Borxhit dhe të Likuiditetit, por ka nevojë të ketë më shumë përqendrim te parashikimi i likuiditetit, përfshirë analizën e luhatjeve.

Ka qenë e kufizuar ecuria në zbatimin e reformave në këtë fushë, prandaj dhe do të rriten përpjekjet për të zgjeruar funksionimin e menaxhimit të borxhit dhe proceseve të reformës për parashikimin monetar. Drejtoria e Borxhit do të përpiqet të prezantojë instrumente të reja me parametra matës për titujt qeveritarë dhe, në të njëjtën kohë, do të analizojë nga afër tregun kombëtar dhe të huaj të huamarrjes. Megjithatë, që të zhvillohet tregu i brendshëm mund të nevojiten më shumë se tre vjet (afati kohor i strategjisë), për shkak të sfidave të vazhdueshme me të cilat ballafaqohet Drejtoria e Borxhit, si baza e varfër e investitorëve dhe mungesa e drejtuesve dhe e stafit.

Produktet

- Produkti 4.3.1 Përmirësimi i parashikimit të likuiditetit

- Produkti 4.3.2 Përditësimi dhe publikimi i Strategjisë Afatmesme e Menaxhimit të Borxhit dhe plotësimi i objektivave të vendosur

- Produkti 4.3.3 Zgjerimi i tregut primar dhe sekondar

Komponenti 4.4 Prokurimi publik

Objektivi

Krijimi i një sistemi efektiv dhe efikas për prokurimin publik në Shqipëri, në përputhje me praktikat më të mira ndërkombëtare që garanton transparencë të lartë, llogaridhënie, kontroll dhe vlerën e parasë.

Konteksti

LPP-ja është ndryshuar për t'u harmonizuar me direktivat e BE-së dhe për të rritur pavarësinë e KPP-së. Me miratimin e ndryshimeve të LPP-së, sipas të cilave KPP-ja kaloi në varësi të parlamentit, duhet të sigurohet emërimi i anëtarëve të rinj të KPP-së, në bazë të meritës; duhen nxjerrë udhëzime të reja gjithëpërfshirëse; duhen krijuar burimet e nevojshme buxhetore, ambiente për zyra dhe masa të tjera për funksionimin e duhur të KPP-së.

Do të vijojë zhvillimi i një sistemi të prokurimit elektronik dhe, sipas nevojës, do të përgatiten edhe manualet e përdorimit dhe udhëzuesit. Deri tani, ende nuk ka filluar aktiviteti që ishte planifikuar për rritjen e kontrolleve gjatë para angazhimit (faza e prokurimit) dhe mekanizmi ka nevojë të rishikohet më tej nga Thesari dhe APP-ja, për të përcaktuar afatet kohore dhe procesin e prokurimit gjatë të cilit duhen angazhuar fondet në SIFQ.

Produktet

Produktet përfshijnë:

- Produkti 4.4.1 Përafrimi i ligjit për prokurimin publik me direktivat e reja të BE-së

- Produkti 4.4.2 Komisioni i Prokurimit Publik ofron mbrojtje ligjore për tenderuesit dhe mbron interesin publik përgjatë gjithë fazave të prokurimit publik

- Produkti 4.4.3 Zgjerimi i mëtejshëm i sistemit të prokurimit elektronik

- Produkti 4.4.5 Krijimi i mekanizmave për të kontrolluar nëse ka fonde në gjendje, përpara se të çelet procesi i prokurimit

Komponenti 4.5 Menaxhimi i fondeve të jashtme

Objektivi

Buxhetim efektiv dhe përdorimi transparent i sistemeve qeveritare të menaxhimit dhe të kontrollit për të gjitha fondet e jashtme, duke përfshirë projektet e financuara nga BE-ja, në kuadrin e programeve IPA, në mënyrë të decentralizuar.

Konteksti

SIMAJ-ja është aktive që prej fundqershorit 2018 dhe përdoret për të menaxhuar dhe për të raportuar zhvillimet në financim. U zhvillua fillimisht nga KM-ja, me një fond nga shumë donatorë, financuar nga Banka Botërore, BE-ja, qeveria suedeze, qeveria zvicerane dhe administruar nga Banka Botërore. Gjatë tremujorit të tretë të viti 2017, menaxhimi i SIMAJ-së ka kaluar nën përgjegjësinë e MFE-së. Ka përfunduar testimi i sistemit dhe janë trajnuar përdoruesit mbi mënyrën e përdorimit të tij. Sistemi SIMAJ ka si synim të jetë një sistem i integruar në gjithë vendin që përdoret nga MFE-ja, partnerët për zhvillim dhe integrim (PZHI) dhe zyrtarët

qeveritarë për t'iu ofruar të gjithë aktorëve mundësinë për të hedhur të dhëna, analiza dhe raporte. Është krijuar për të ndihmuar MFE-në dhe autoritetet shqiptare të ulin përpjekjet dhe kostot e transaksioneve në mbledhjen dhe analizimin e të dhënave.

Produkti

Megjithëse futja e fondeve të jashtme në buxhet ndodh në shumicën e vendeve, MFE-ja do të vazhdojë përpjekjet për ta bërë këtë si më poshtë:

- Produkti 4.5.1 Informacioni i SIMAJ-së për fondet e jashtme është i plotë dhe i përditësuar në mënyrë periodike

Komponenti 4.6 Forcimi i rolit të ndihmës shtetërore

Objektivi

Forcimi i efektivitetit të rolit të ndihmës shtetërore.

Konteksti

Detyrimet e Shqipërisë në fushën e konkurrencës dhe të ndihmës shtetërore, janë parashikuar në nenet 40, 70 dhe 71 të marrëveshjes së stabilizim-asocimit (MSA). Autoriteti i Konkurrencës u themelua në vitin 2004, në zbatim të ligjit nr. 9121, datë 28 korrik 2003, "Për mbrojtjen e konkurrencës" dhe fokusohet në promovimin dhe mbrojtjen e konkurrencës së lirë në Shqipëri. Efekti i ligjit është forcuar më tej nga vendosja e sanksioneve mbi kompanitë për sjellje antikonkurruese në treg.

Në fushën e ndihmës shtetërore, u miratua një kuadër i plotë ligjor në vitin 2006 dhe tashmë ekziston një sistem kombëtar kontrolli për të mbikëqyrur dhe për të monitoruar aktivitetet. Kuadri ligjor përfshin ligjin nr. 9374, datë 21 prill 2005, "Për ndihmën shtetërore", tri rregullore pune të miratuara nga Këshilli i Ministrave, si dhe një grupim udhëzuesish me disa aspekte ose kategori të ndihmës shtetërore, të miratuara me vendime të Komisionit të Ndihmës Shtetërore. Komisioni në fjalë ka punuar vazhdimisht për të rritur numrin e njoftimeve për skemat e ndihmës shtetërore nga ofruesit e kësaj ndihme, me qëllim promovimin e punësimit, duke përfshirë propozimet për projektvendimet për proceset vendimmarrëse. Sfidat me të cilat ballafaqohet ndihma shtetërore janë: a) nevoja për më shumë bashkëpunim në aspektin parandalues mes politikbërësve, autoriteteve publike dhe organeve rregullatore për të mbrojtur dhe rritur konkurrencën në tregjet ku ka ndërhyrje nga shteti; b) nevoja për të forcuar më shumë kapacitetin administrativ të strukturave dhe institucioneve të ngarkuara me kontrollin e ndihmës shtetërore (fokusi kryesor i të cilëve është forcimi i aftësimit të stafit në këtë sektor).

Produkti

Prandaj, MFE-ja do të vazhdojë të sigurohet se objektivi është realizuar tërësisht:

- Produkti 4.6.1 Përmirësimi i kuadrit rregullator për ndihmën shtetërore

- Produkti 4.6.2 Krijimi i një baze të dhënash për zbatimin efektiv të skemës së ndihmës shtetërore dhe

- Produkti 4.6.3 Organizimi i fushatave të ndërgjegjësimit mbi rolin dhe detyrat e Komisionit të Ndihmës Shtetërore

Objektivi specifik 5. Transparenca e financave publike

Objektivi

Përmirësimi i mbulimit, cilësisë dhe aksesueshmërisë së informacionit për financat publike.

Ecuria që prej vitit 2014

Që në fillim të zbatimit të Strategjisë, fokusi kryesor ka qenë forcimi i sistemeve dhe i kapaciteteve për t'i përgatitur statistikat qeveritare financiare (SQF), në përputhje me standardet ndërkombëtare. Gjatë vitit 2017, INSTAT-i hartoi dhe transmetoi për herë të parë, të dhënat SFQ, sipas kërkesave të programit të transmetimit 2010, të sistemit evropian të llogarive (SELL) 2010. Grupi ndërinstitucional i punës (INSTAT-i, MFE-ja dhe Banka e Shqipërisë) përgatiti dhe publikoi listën e njësive të qeverisjes së përgjithshme, pjesë e sektorit publik, sipas MSFQ 2014 dhe SELL 2010. Për më tepër, janë krijuar disa ndërfaqe mes SIFQ-së dhe burimeve të tjera të të dhënave, për të garantuar një sistem statistikor më fleksibël dhe më të besueshëm.

Sipas Anketimit për Buxhetin e Hapur (2017), që prej vitit 2015, Shqipëria ka rritur: a) disponueshmërinë e informacionit buxhetor në raportin e auditimit dhe pasqyrën parabuxhetore;

dhe b) numrin e raporteve të botuara për zbatimin e buxhetit. Gjithashtu, janë përmirësuar procedurat për zbatimin e buxhetit gjatë vitit, si dhe për herë të parë u botua në faqen e internetit të MFE-së[14] raporti gjashtëmujor i qeverisë për performancën makroekonomike, fiskale dhe buxhetore, në vitin 2017. Tani përgatiten edhe raportet tremujore bazuar në udhëzimet e reja. MFE-ja është asistuar nga nisma BOOST, një mjet nga Banka Botërore që ofron platforma të thjeshta për përdoruesin, ku mund të aksesohen lehtë të dhënat mbi shpenzimet dhe të ardhurat që të përdoren nga hulumtuesit, zyrtarët qeveritare dhe qytetarët e thjeshtë, për të analizuar tendencat në mënyrën e alokimit të burimeve publike, për të analizuar burimet e mundshme të mosefikasitetit, si dhe të informohen më mirë për financat qeveritare dhe shpërndarjen e shërbimeve publike.

Së fundmi, është bërë progres në përmirësimin e transparencës dhe përfshirjen e publikut. Informacioni financiar për qeverisjen qendrore dhe vendore botohet në faqen e MFE-së, përfshirë në "Portalin e transparencës" mbi financat vendore.

U realizua një analizë hendeku për kontabilitetin, për të krahasuar kuadrin rregullator të kontabilitetit me SNKSP-në, në mënyrë që të merren marrat e duhura për zbatimin e kontabilitetit, në bazë të drejtash dhe detyrimesh të konstatuara. Gjithashtu, në DPH/KBFP u krijua një funksion i posaçëm për kontabilitetin, i cili do të ketë përgjegjësinë të përditësojë metodologjinë e kontabilitetit në sektorin publik, si dhe të hartojë akte ligjore dhe nënligjore në sektorin privat. Gjatë vitit 2018, DHMFK-ja në bashkëpunim me Drejtorinë e Buxhetit dhe me Drejtorinë e Thesarit hartuan dhe aprovuan udhëzimin nr. 8, datë 9.3.2018, "Për procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", qëllimi i të cilit ishte përcaktimi i bazës rregullatore për përgatitjen, paraqitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore, bazuar në kuadrin rregulaltor të fushës. Megjithatë, kjo është një masë tranzitore deri në zbatimin e plotë të standardeve që janë në përputhje me SNKSP-në.

Mësimet e nxjerra dhe prioritetet për periudhën 2019–2022

Ky objektiv specifik përfshin një numër të ndryshëm aktorësh në fushën e MFP-së, përfshirë Drejtoritë e Buxhetit dhe të Thesarit, INSTAT-in, Bankën e Shqipërisë dhe të tjerë. Në një mënyrë, ky fakt ka ndikuar në aftësinë e aktorëve për të identifikuar prioritetet në vazhdimësi dhe prioritetet e reja brenda këtij objektivi specifik. Mbetet detyrë e vështirë përgatitja e llogarive kombëtare të qeverisë, sipas SELL 2010. Megjithatë, pritet që të përmirësohet me zbatimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit mes MFE-së, Bankës së Shqipërisë dhe INSTAT-it, në bazë të së cilës rolet dhe përgjegjësitë do të zhvillohen më tej dhe do të rriten me vijimin e progresit në raportimin e SELL 2010. Autoritetet do të vazhdojnë punën me asistencën teknike të FMN-së për të forcuar koordinimin, si edhe mbi sistemet e hartimit dhe të shpërndarjes, në përputhje me *MSFQ 2014* dhe *SELL 2010*.

Një nga mangësitë e raportimit financiar dhe sistemit të monitorimit ka qenë copëzimi i proceseve të raportimit dhe integrimi i pakët i instrumenteve me njëri-tjetrin. Si rrjedhojë, ka qenë e vështirë të krijohej një ide e përgjithshme mbi ecurinë e zbatimit të buxhetit, llogaritë e qeverisë, borxhin publik, risqet fiskale, koncesionet (përfshirë PPP-të) dhe detyrimet. Prandaj, rritja e llogaridhënies për performancën financiare dhe jofinanciare nëpërmjet një raportimi transparent do të vazhdojë të mbetet në fokus edhe përgjatë viteve të ardhshme.

Pikët, sipas Indeksit për Buxhetin e Hapur (IBH), ishin më pak për vitin 2017 krahasuar me anketimin e vitit 2015 (nga 15/100 në 2015-ën në 2/100 në 2017-ën) dhe përfundimi ishte se Shqipëria ofron "pak" mundësi që publiku të angazhohet në procesin buxhetor. Në vitet pasardhëse aktivitetet do të synojnë të rrisin dhe të inkurajojnë pjesëmarrjen e qytetarëve në proces.

Progresi për kalimin drejt një sistemi kontabilitetit mbi bazë të drejtash dhe detyrimesh të konstatuara ka qenë më i ngadaltë nga sa pritej, kryesisht për shkak të natyrës së ndërlikuar dhe të

[14] http://www.financa.gov.al/al/raportime/buxheti/buxheti-ne-vite/buxheti-2017/raporti-i-mes-vitit-mbi-zbatimin-e-buxhetit-2017.

dekoncentruar të kësaj reforme. Zhvillimi i kuadrit rregullator të kontabilitetit dhe atij ligjor, në fushën e kontabilitetit me bazë të drejtash e detyrimesh të konstatuara, vazhdon të mbetet prioritet në Strategjinë e Menaxhimit të Financave Publike, megjithëse në një plan kohor më të gjatë nga ai që ishte parashikuar fillimisht. Në të ardhmen e afërt do të hartohet dhe do të adaptohet plani strategjik kombëtar i veprimit, i cili do të përmbajë fazat dhe aktivitetet që do të ndiqen në kuadër të zbatimit gradual të kontabilitetit në bazë të drejtash e detyrimesh të konstatuara.

Zona specifike të reformës janë përmbledhur në tabelën 2.5 më poshtë.

Tabela 2.5 Ndërhyrjet kryesore dhe rezultatet

Ndërhyrjet kryesore/komponentët	Drejton	Rezultatet
5.1 Llogaritë kombëtare të qeverisë	**INSTAT**	XV. Sisteme dhe kapacitete të forcuara për të përgatitur pasqyra financiare qeveritare në përputhje me standardet ndërkombëtare XVI. Përgjegjshmëri dhe transparencë e rritur nëpërmjet raportimit të performancës financiare dhe jofinanciare XVII. Ofrimi i mundësive formale që publiku të angazhohet në procese buxhetore XVIII. Paraqitja e pasqyrave financiare, sipas kuadrit rregullator, në përputhje me SNKSP -in e përzgjedhur XIX. Përgatitja dhe publikimi i regjistrit të plotë të aktiveve në sektorin publik, bazuar në rregulloret e përmirësuara për vlerësimin dhe inventarin e këtyre aktiveve
5.2 Monitorimi dhe raportimi financiar i performancës	**DMB**	
5.3 Angazhimi i qytetarëve	**DAPB**	
5.4 Kontabiliteti	**DHMFKK**	
5.5 Menaxhimi i përmirësuar i aktiveve	**DHMFKK**	

Komponenti 5.1 Llogaritë kombëtare të qeverisë

Objektivi

Prodhimi i "Statistikave financiare të qeverisë" në kohë dhe të besueshme.

Konteksti

Është bërë progres në forcimin e INSTAT-it, megjithatë ka pasur devijim në zbatimin e këtij komponenti, duke qenë se ky i fundit përbëhej nga një grupim nënmasash të ndërlikuara që kërkonin koordinim efektiv ndërmjet tri institucioneve të ndryshme: Bankëa së Shqipërisë, MFE-së dhe INSTAT-it. Duhet përgatitur një sistem statistikor i standardizuar dhe gjithëpërfshirës për njësitë e qeverisjes së përgjithshme, i cili të shoqërohet me rishikim politikash, procedurash standarde dhe formatesh që mundësojnë përgatitjen e raporteve në lidhje me statistikat financiare të qeverisë, sipas SELL 2010. Në këtë kontekst, gjatë viteve në vijim, fokusi do të jetë në fuqizimin e grupit ndërinstitucional të punës, si edhe ngritjen e sistemit të integruar SQF. Për më tepër, tabelat e "Procedurës së deficitit të tepërt" (EDP) dërgohen rregullisht në EUROSTAT që prej vitit 2014, por gjithsesi ato kërkojnë zhvillim të mëtejshëm. Prioritetet e kësaj faze përfshijnë:

Produktet

- Produkti 5.1.1 Ndërtimi i një sistemi statistikor të qëndrueshëm, për njësitë e qeverisjes së përgjithshme

- Produkti 5.1.2 Rishikimi i tabelave EDP, si edhe krijimi i një sistemi statistikor gjithëpërfshirës

Komponenti 5.2 Monitorimi dhe raportimi financiar dhe i performancës

Objektivi

Publikimi i raporteve gjatë vitit dhe atij vjetor përmbajnë informacion të aksesueshëm për performancën financiare dhe jofinanciare.

Konteksti

Janë përmirësuar raportet për zbatimin e buxhetit gjatë vitit, raporti gjashtëmujor për performancën makroekonomike, fiskale dhe buxhetore, si dhe raportet e fundvitit. Megjithatë, MFE-ja, për të pasur sa më shumë transparencë dhe integrim të shpenzimeve publike, do të punojë në drejtim të përmirësimit për të përgatitur një raport më gjithëpërfshirës, i cili do të

shërbejë dhe si dokumenti kryesor që raporton kundrejt planit buxhetor, ecurisë së zbatimit të buxhetit, llogarive të qeverisë, borxhit publik, koncesioneve (përfshirë PPP-të) dhe detyrimeve.

Produktet

- Produkti 5.2.1 Botimi i një raporti të përmirësuar vjetor për zbatimin e buxhetit

- Produkti 5.2.2 Botimi i një raporti të përditësuar për zbatimin e buxhetit gjatë vitit, përfshirë raportin për rishikimin gjashtëmujor

Komponenti 5.3 Angazhimi i qytetarëve

Objektivi

Ofrohen mundësi formale për publikun të angazhohet në planifikimin dhe zbatimin e buxhetit.

Konteksti

Megjithëse informacioni financiar për qeverisjen qendrore dhe atë lokale është publikuar në *website*-in e MFE-së dhe në "Portalin e transparencës" mbi financat lokale, demonstron progres, ka nevojë për më shumë punë për ta pasuruar informacionin e disponueshëm, si dhe për të angazhuar në mënyrë aktive organizatat e shoqërisë civile (OSHC) dhe aktorët e tjerë, si për shembull, akademikët, gjatë përgatitjes dhe zbatimit të buxhetit. Do të përgatitet një platformë komunikimi për të ndihmuar qytetarët të shkëmbejnë pikëpamjet e tyre mbi çështjet buxhetore kombëtare qoftë gjatë fazës së përgatitjes së buxhetit edhe gjatë monitorimit të zbatimit të tij. Gjithashtu, do t'u ofrohen trajnime OSHC-ve, për të kuptuar më mirë planifikimin dhe zbatimin e buxhetit, si dhe raportet përkatëse.

Produktet

MFE-ja do të punojë për t'u angazhuar në mënyrë më të strukturuar dhe në kohë me qytetarët, organizatat e shoqërisë civile dhe me akademikët për planifikimin, monitorimin dhe raportimin e buxhetit.

- Produkti 5.3.1 Përgatitja e një udhëzuesi për buxhetin për qytetarët

- Produkti 5.3.2 Përgatitja dhe vendosja në zbatim e kalendarit për dëgjesat buxhetore që përmbajnë proceset kryesore buxhetore

Komponenti 5.4 Kontabiliteti

Objektivi

Kontabilitetit është në përputhje me "Standardet ndërkombëtare të kontabilitetit për sektorin publik" (SNKSP)

Konteksti

IB-të në Shqipëri përdorin një sistem të modifikuar të kontabilitetit të bazuar në vlera monetare, me disa elemente të parimit të kontabilitetit mbi bazë të drejtash e detyrimesh të konstatuara, kryesisht për aktivet fizike, arkëtimet dhe detyrimet. Qeveria synon që gradualisht të përshtatë, pjesërisht ose plotësisht, "Standardet ndërkombëtare të kontabilitetit në sektorin publik" (SNKSP), duke mbajtur parasysh kontekstin e Shqipërisë, por nuk është specifikuar ende një datë indikative kur mund të përfundojë ky proces. Është realizuar një analizë e mangësive në vitin 2017, e cila krahason kuadrin rregullator ekzistues në vendin tonë me SNKSP-në dhe hedh bazat për të marrë masa të mëtejshme nën këtë komponent. Duhet pasur parasysh se reforma e kontabilitetit në sektorin publik është një objektiv ambicioz, për të cilin është e vështirë të parashikohet saktësisht afati kohor për zbatimin e saj, prandaj dhe kjo e fundit do të vijojë me hapa të vegjël në drejtimin e duhur, duke pasur në fokus krijimin e një mjedisi të përshtatshëm që e mundëson këtë reformë. Në vitin 2018, u krijua një funksion i posaçëm për kontabilitetin, në Drejtorinë e Harmonizimit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin në MFE, përgjegjëse për hartimin dhe aprovimin e metodologjisë për kontabilitetin në fushën e sektorit publik, si dhe për aktet ligjore dhe nënligjore për kontabilitetin në sektorin privat.

Kjo strukturë do të mbështesë procesin e kalimit drejt kontabilitetit me bazë të drejtash e detyrimesh dhe detyrimesh të konstatuara nëpërmjet adaptimit të kuadrit rregullator, që është në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik (SNKSP).

Zhvillimi i kuadrit rregullator të kontabilitetit dhe atij ligjor, në fushën e kontabilitetit me bazë të drejtash e detyrimesh të konstatuara, vazhdon të mbetet prioritet në Strategjinë e Menaxhimit

të Financave Publike, megjithëse në një plan kohor më të gjatë nga ai që ishte parashikuar fillimisht. Gjatë vitit 2019 do të hartohet dhe do të miratohet plani strategjik kombëtar i veprimit, që do të përmbajë fazat dhe aktivitetet që do të realizohen për zbatimin gradual të kontabilitetit në bazë të drejtash dhe detyrimesh të konstatuara. Reforma do të fillojë me ML-në dhe agjencitë e tyre, prandaj është e rëndësishme të rritet ndërgjegjësimi në të gjitha nivelet e menaxhimit. Më rëndësi të veçantë është rritja e ndërgjegjësimit të drejtuesve financiarë, mbi përfitimet që sjell kontabiliteti në bazë të drejtash e detyrimesh krahasuar me kontabilitetin me bazë monetare.

Produktet

MFE-ja, gradualisht do të përafrojë pasqyrat financiare vjetor me standardet ndërkombëtare nëpërmjet:

- Produkti 5.4.1 Një plani zbatimi për kuadrin rregullator në përputhje me SNKSP-në;

- Produkti 5.4.2 Përmirësimi i kuadrit rregullator të kontabilitetit;

- Produkti 5.4.3 Zgjerimi i SIMFSH-së për të regjistruar të dhëna të kontabilitetit mbi bazë të drejtash e detyrimesh të konstatuara dhe

- Produkti 5.4.4 Zbatimi i planit për zhvillimin e kapaciteteve

Komponenti 5.5 Përmirësimi i menaxhimit të aktiveve

Objektivi

Përgatitja dhe publikimi i regjistrit të plotë të aktiveve në sektorin publik, bazuar në rregullore të përmirësuara për vlerësimin dhe inventarizimin e këtyre aktiveve.

Konteksti

DPTH-ja bën një bilanc me vlerat e aktiveve jofinanciare, por regjistri i aktiveve është i paplotë. Rregullat ekzistuese të kontabilitetit konsiderohen të papërshtatshme dhe vendimmarrësit në MFE nuk e konsiderojnë të dobishëm këtë informacion për qëllimet e tyre. Tashmë, aktivet publike të gjashtë IB-ve janë hedhur në SIFQ dhe ka përfunduar transferimi i aktiveve publike për qeverinë vendore. Zbatimi i këtij komponenti ka qenë pjesë e shtyllës 4, "Zbatimi efikas i buxhetit". Ka pasur vonesa në zbatimin e tij gjatë katër vjetëve të parë të zbatimit të strategjisë, për shkak të reformës territoriale, si dhe ndryshimeve institucionale brenda në qeveri. MFE-ja është e ndërgjegjshme se është e nevojshme të ketë koordinim, pasi, si përgatitja e metodologjive dhe udhëzimeve për njohjen dhe vlerësimin e aktiveve, si dhe për inventarizimin e tyre fizik, kërkon marrjen në zotërim të procesit nga ana e ministrive të linjës dhe agjencive të varësisë.

Produktet

Kjo punë do të vijojë paralelisht me reformën për kontabilitetin me bazë të drejtash e detyrimesh të konstatuara, për përgatitjen e metodologjisë, formateve dhe udhëzuesve për regjistrimin e plotë të aktiveve, për të gjitha institucionet.

- Produkti 5.5.1 Përgatitja e metodologjisë dhe udhëzimeve për inventarin e plotë të aktiveve publike për qeverinë qendrore (QQ)

- Produkti 5.5.2 Regjistrimi i inventarit të plotë të aktiveve publike në SIFQ nga IB-të që kanë akses të drejtpërdrejtë në sistem

- Produkti 5.5.3 Regjistrimi i plotë i aktiveve publike në *Exel* (për IB-të që nuk kanë akses të drejtpërdrejtë në SIMFSH)

Objektivi specifik 6. Kontrolli i brendshëm efektiv

Objektivi

Forcimi dhe zbatimi i sistemit për Kontrollin e Brendshëm Financiar Publik në qeverisjen qendrore dhe vendore.

Ecuria që prej vitit 2014

Gjatë kësaj periudhe janë bërë ndryshime/përmirësime në ligjet: "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", "Për auditimin e brendshëm" dhe "Për inspektimin financiar publik", si dhe janë miratuar disa akte nënligjore në zbatim të legjislacionit parësor. DH-ja/MFK-ja ka ndërmarrë një sërë aktivitetesh për të rritur ndërgjegjësimin e nëpunësve dhe drejtuesve të nivelit të lartë mbi rëndësinë e zbatimit me sukses të MFK-së. Është arritur progres në këtë fushë, por ende mbeten

disa çështje për t'u adresuar të cilat lidhen kryesisht me procedurat e delegimit të kompetencave, linjat e raportimit etj.

Janë realizuar rreth 60 aktivitete monitorimi në terren për funksionimin e sistemit MFK dhe Auditit të Brendshëm (AB) në disa prej IB-ve, si dhe disa aktivitete për ngritjen e kapaciteteve, përfshirë trajnime, këshillime dhe vizita studimore. Shumë prej këtyre aktiviteteve u mbështetën nga Projekti i Binjakëzimit me Austrinë dhe Francën, i financuar nga BE-ja.

Janë krijuar më shumë njësi auditimi të brendshëm në qeverinë qendrore dhe vendore (aktualisht 130) dhe 75 për qind e audituesve të brendshëm janë certifikuar nga Komisioni i Kualifikimit të Audituesve të Brendshëm (KKAB). Gjithashtu, për të krijuar një funksion efektiv për inspektimin financiar publik, u përzgjodhën 85 inspektues të jashtëm për të ndihmuar Drejtorinë e Inspektimit Financiar Publik, për të kryer inspektime sipas ekspertizës së kërkuar. Nënshkrimi i 17 marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione të ndryshme kanë ndihmuar në forcimin e funksionit të rrjetit të Shërbimit të Koordinimit Antimashtrim (SHKA).

Mësimet e nxjerra dhe prioritetet për periudhën 2019–2022

Ka pasur vështirësi gjatë zbatimit të këtij objektivi specifik gjatë periudhës së shkuar. Në Strategji mungonin masat që synojnë rritjen e numrit të IB-ve që përdorin buxhetimin sipas performancës si parakusht për zbatimin e MFK-së. Gjithashtu, shumë prej masave fokusoheshin në ndryshimet ligjore dhe aktivitetet për rritjen e kapaciteteve mbi instrumentet e MFK-së dhe më pak aktivitete kishin si fokus garantimin se MFK-ja zbatohet në mënyrë të suksesshme.

Gjatë periudhës 2015–2017 u bënë edhe shumë ndryshime ligjore, si dhe u organizuan trajnime për të forcuar funksionin e auditimit të brendshëm, si dhe u kryen inspektime financiare publike. Megjithatë, edhe pse është i fortë kuadri ligjor dhe operacional, mbetet sfidë zbatimi i tij. Disa nga faktorët që ndikuan negativisht në forcimin e këtyre funksioneve ishin: a) vonesa në plotësimin e vendeve të lira të punës në nivel institucioni buxhetor; dhe b) mungesë kapaciteti profesional për disa nga inspektorët e jashtëm.

Sipas raportit të MPQM-së[15], zhvillimet në MFK, në nivel organizativ, ende nuk kanë njohur të njëjtin nivel zhvillimi si kuadri i përgjithshëm legjislativ. Prandaj, duhet të vendoset më shumë theksi në forcimin e zbatimit të KBFP-së në të ardhmen. Për këtë qëllim, duhet të përgatitet një dokument strategjik për KBFP-në, ku do të parashikohet një drejtim më i madh strategjik për Kontrollin e Brendshëm, si dhe do të propozohet vizioni si mendohet që të funksionojë, hendeqet që duhen trajtuar, si dhe koordinimi i masave korrigjuese. Veç këtyre, ky dokument do të theksojë rëndësinë që ka njohja dhe zbatimi i parimit të "llogaridhënies menaxheriale", për të konsideruar në mënyrë më eksplicite rekomandimet e MPQM-së dhe për të zvogëluar riskun që vjen si pasojë e zgjidhjeve të pakoordinuara/ndryshimeve ligjore, si dhe prej vonesave të pajustifikueshme në fazën e zbatimit.

Gjatë fazës pasardhëse qeveria do të synojë të thellojë reformën për KBFP-në, për të përshpejtuar zbatimin për të përmbushur objektivat e këtij objektivi specifik. Në tabelën 2.6 më poshtë janë paraqitur ndërhyrjet specifike.

Tabela 2.6 Ndërhyrjet kryesore dhe rezultatet

Ndërhyrjet kryesore/komponentët	Drejton	Rezultati
6.1 Menaxhimi financiar dhe kontrolli në të gjitha institucionet publike	**DHMFKK**	XX. Llogaridhënie menaxheriale efektive për të gjitha institucionet publike XXI. Roli i forcuar i auditimit të brendshëm në sektorin publik XXII. Një inspektim financiar publik efikas
6.2 Auditimi i brendshëm	**DHAB**	
6.3 Inspektimi financiar publik	**DIFP**	

Komponenti 6.1 Menaxhimi financiar dhe kontrolli në të gjitha institucionet publike

Objektivi

Llogaridhënie menaxheriale efektive në gjitha institucionet publike.

[15] http://www.sigmaweb.org/publications/Monitoring-Report-2017-Albania.pdf#page=124&zoom=100,0,105

Konteksti

Forcimi i MFK-së mbetet ende në prioritet për vitet e ardhshme, por tani theksi vendoset më shumë në zbatimin e llogaridhënies menaxheriale në kuadër të Reformës së Administratës Publike (RAP) dhe buxhetimin në bazë performance që e bëjnë sistemin më të orientuar drejt produktit. Strategjia e RAP-së[16], në veçanti, synon: të delegojë vendimmarrjen më afër pozicioneve që janë përgjegjëse për këtë funksion dhe të mosmbingarkojë drejtuesin e një institucioni me vendime operacionale.

Problematikë vazhdon të mbetet zbatimi i plotë i kërkesave të legjislacionit të MFK-së. Ende nuk është futur koncepti i llogaridhënies menaxheriale, sepse: a) delegimi i autoritetit funksionon shumë pak në praktikë dhe vetëm një numër i vogël vendimesh delegohen; dhe b) llogaridhënia menaxheriale nuk funksionon vertikalisht me organizatat në varësi, sepse personi që ka përgjegjësinë për fushën e politikave nuk është në gjendje të influencojë dhe të monitorojë aktivitetet në organizatat e varësisë. Për shembull, duhet të ketë organizime konkrete qeveritare me objektiva të synuar dhe të matshëm për këto organe, të cilat duhet të miratohen me ministrinë mëmë që monitoron progresin. Këto marrëdhënie deri tani nuk kanë funksionuar, prandaj duhet bërë më shumë punë për të forcuar organizimin institucional dhe për të ndryshuar kulturën e punës.

Sipas ligjit të MFK-së, të ndryshuar, bordi i KBFP-së, ndër të tjera, ka përgjegjësinë të rishikojë miratimin e kuadrit ligjor ose të përmirësojë kuadrin e KBFP-së, si dhe të diskutojë raportin vjetor të KBFP-së, para se të miratohet nga ministri i Financave dhe Ekonomisë. Megjithatë, ligji i jep bordit vetëm funksion këshillimor; pa kompetenca për të miratuar raportin vjetor apo për të ngritur probleme sistematike, apo për të dhënë rekomandime për trajtimin e gjetjeve specifike apo të përgjithshme të KBFP-së pranë Këshillit të Ministrave. Gjithashtu, përgjatë viteve në vijim, MFE-ja do të fokusohet në zbatimin në praktikë të instrumenteve të MFK-së, nëpërmjet hartimit të një dokumenti strategjik mbi zhvillimet e mëtejshme të KBFP-së, metodologjisë së sistemit të MFK-së, si dhe asistencës së vazhdueshme në terren.

Produktet

MFE-ja do të vazhdojë të trajtojë këto mangësi që menaxhimi financiar dhe kontrolli, në veçanti koncepti i llogaridhënies menaxheriale të zbatohet dhe të kuptohet më tej. Më konkretisht, në fokus do të jenë:

- Produkti 6.1.1 Krijimi i një sistemi menaxhimi financiar dhe mjedisi kontrolli të brendshëm më të fortë

- Produkti 6.1.2 Funksionimi i sistemeve për kontrollin e brendshëm

- Produkti 6.1.3 Forcimi i sistemit të monitorimit i KBFP-së

Komponenti 6.2 Auditimi i brendshëm

Objektivi

Forcimi i funksionit të auditimit të brendshëm në sektorin publik.

Konteksti

Do të mbetet në fokus përmirësimi i funksionit të auditimit të brendshëm dhe do të vendoset më shumë theksi te shkalla e zbatimit të rekomandimeve të auditimit të brendshëm dhe, nëse këto rekomandime kontribuojnë efektivisht në përmirësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm brenda IB-ve.

Pjesa më e madhe e aktiviteteve, sipas Strategjisë 2014–2020, i ishin dedikuar modernizimit të praktikave dhe operacioneve në auditimin e brendshëm. Këto përfshinin edhe kalimin nga auditimet e përputhshmërisë në teknikat e auditimit që sjellin vlerë të shtuar dhe në forcimin e komponentit për menaxhimin e riskut në praktikë e ngritjen e kapaciteteve për audituesit e brendshëm, si dhe në krijimin e komitetit të auditimit. Megjithatë, ka ende nevojë për punë për të përmirësuar auditimin e brendshëm në të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme, i cili do të trajtohet në Strategjinë e rishikuar.

[16] Strategjia Ndërsektoriale e Reformës në Administratën Publike, 2015–2020.

Produktet

Për këtë arsye, MFE-ja do të vazhdojë të trajtojë mangësitë, në mënyrë që funksioni i auditimit të brendshëm të kontribuojë në mënyrë aktive në përmirësimin e menaxhimit të financave publike.

- Produkti 6.2.1 Përmirësimi i funksionit të auditimit të brendshëm në të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme

- Produkti 6.2.2 Kontributi i auditimit të brendshëm në mënyrë efektive në përmirësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm

Komponenti 6.3 Inspektimi financiar publik

Objektivi

Përmirësimi i efikasitetit të inspektimit financiar publik.

Konteksti

Do të mbetet në fokus forcimi i funksionit të inspektimit financiar publik, pasi shihet si një mjet i rëndësishëm për të mbrojtur interesat financiarë publikë dhe për të garantuar respektimin e rregullave të shtetit.

Në vitin 2014, hyri në fuqi ligji i ri, "Për inspektimin financiar publik" dhe, në zbatim të tij u përgatitën shumë akte nënligjore, udhëzues dhe manualë. Këto ndryshime legjislative u shoqëruan dhe me ndryshime organizative, si p.sh., u krijua Drejtoria e Inspektimit Financiar Publik (DIFP) si një funksion më vete në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, e përbërë nga dy sektorë: a) analiza, hetimi, monitorimi dhe SHKA-ja; dhe b) inspektimi financiar publik. U kryen shumë aktivitete për forcime kapacitetesh, si: trajnime, këshillime, vizita studimore, të cilat kontribuuan shumë në rritjen e profesionalizmit të stafit dhe e njëjta gjë është parashikuar për katër vitet në vijim. Megjithatë, mbetet i dobët si funksion, për shkak të mungesës së aftësive profesionale të inspektorëve të jashtëm, si dhe prej vendeve vakante që duhen plotësuar në DIFP.

Qeveria është e vendosur të krijojë një sistem kontrolli që parandalon rastet e mashtrimit, parregullsitë dhe keqmenaxhimet e tjera financiare me fondet publike në sektorin publik. Për më tepër, MFE-ja ka përgjegjësinë të kryejë analiza, hetime dhe monitorime, njësoj si Shërbimi për Koordinimin Antimashtrim. Prandaj, do të miratohet dhe do të zbatohet një dokument strategjik kombëtar antimashtrim, për të rritur mbrojtjen e interesave financiarë, ndër të tjera, atyre të BE-së.

Produkti

MFE-ja do të vijojë të forcojë funksionin e inspektimit financiar që të kontribuojë aktivisht në përmirësimin e menaxhimit të financave publike.

- Produkti 6.3.1 Rritja e rolit të inspektorëve financiarë të brendshëm dhe të jashtëm

- Produkti 6.3.2 Hartimi i një strategjie kombëtare kundër mashtrimit për mbrojtjen e interesit financiar të BE-së

Objektivi specifik 7. Mbikëqyrje e jashtme efektive e financave publike

Objektivi

Auditimi i jashtëm është në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Konteksti

Mbikëqyrja efektive nga Kuvendi për t'i kërkuar llogari qeverisë për punën që ka kryer është pjesë thelbësore e ciklit të MFP-së. Në përmbushje të rolit të tij ka një funksion të rëndësishëm për të miratuar buxhetin, për të monitoruar zbatimin e tij dhe për të shqyrtuar të gjitha raportet e auditimit. KLSH-ja është një organ i pavarur, që, sipas Kushtetutës raporton vetëm në Kuvend. Pjesë të programit të tij të reformave janë prezantuar dhe janë të përfshira në Strategji, pasi auditimi i jashtëm është komponent i rëndësishëm i reformës së MFP-së. KLSH-ja është anëtar i rëndësishëm i Komitetit Drejtues të MFP-së.

Ecuria që prej vitit 2014

KLSH-ja ka ndjekur qasje, metodologji dhe udhëzime të reja, si Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë dhe Auditimit Financiar, në përputhje me SNISA-në dhe bën planifikimin e auditimeve bazuar në risk. Si rezultat, ky institucion ka përmirësuar përbërjen e portofolit të

llojeve të auditimit, ku përfshihen konkretisht auditimi financiar, auditimi i performancës, auditimi i përputhshmërisë dhe auditimi i TI-së.

Ngritja e kapaciteteve dhe zhvillimi profesional i stafit të auditimit ishte një nga objektivat strategjikë të KLSH-së edhe gjatë kësaj periudhe dhe çdo auditues mori mesatarisht 25 ditë trajnim që e ndihmuan të thellonin njohuritë mbi auditimin financiar dhe të performancës, auditimin e TI-së dhe qasje të tjera tematike.

Pati disa arritje të rëndësishme për të përmirësuar komunikimin dhe angazhimin me parlamentin, qeverinë, medien dhe qytetarët nëpërmjet Strategjisë së Komunikimit të KLSH-së (2017–2019), Strategjisë për Zhvillimin e KLSH-së, 2018–2022 dhe Kodit të Ri të Etikës.

Mësimet e nxjerra dhe prioritetet për periudhën 2019–2022

KLSH-ja ka shfrytëzuar më së miri asistencën teknike dhe projektin e binjakëzimit për të përmirësuar kapacitetin auditues dhe për të zgjeruar gamën e auditimeve që kryen, përtej atyre që bën, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore. Janë kryer një numër auditimesh pilot të TI-së, të performancës dhe financiare në fazën e parë të strategjisë. Megjithatë, mungon një sistem gjurmimi për të parë deri në çfarë mase janë zbatuar rekomandimet nga palët e audituara dhe sesi janë ndjekur nga KLSH-ja apo, qoftë edhe për ndjekjen sistematike nga Kuvendi. KLSH-ja do të vazhdojë të ngrejë kapacitetet dhe të përafrohet më shumë me standardet SNISA. Fushat specifike të reformës janë si më poshtë:

Tabela 2.7 Ndërhyrjet kryesore dhe rezultatet

Ndërhyrjet kryesore/komponentët	Drejton	Rezultatet
7.1 Auditimi i jashtëm	**KLSH**	XXIII. Forcimi i mëtejshëm i auditimit të jashtëm për të maksimizuar vlerat dhe përfitimet në shoqëri

Komponenti 7.1 Auditimi i jashtëm

Objektivi

Forcimi i funksionit të auditimit të jashtëm, duke e përafruar me standardet ONISHA.

Konteksti

Zhvillimi strategjik i KLSH-së, për periudhën 2018–2022, synon ta modernizojë më shumë institucionin dhe t'i përafrojë plotësisht aktivitetet e tij me standardet e Organizatës Ndërkombëtare e Institucioneve Shtetërore të Auditimit (ONISHA).

Gjatë periudhës 2019–2022, KLSH-ja do të vazhdojë të forcojë pavarësinë dhe kapacitetin e tij; të përafrojë sa më shumë standardet ndërkombëtare dhe teknikat moderne dhe të përmirësojë komunikimin me Parlamentin dhe me palë të tjera të rëndësishme të interesit.

Produktet

- Produkti 7.1.1 Rritja e pavarësisë së audituesve

- Produkti 7.1.2 Përafrimi i qasjeve audituese me standardet ndërkombëtare të auditimit dhe

- Produkti 7.1.3 Rritja e ndikimit të auditimit falë rritjes së komunikimit me të gjitha palët e interesit

KAPITULLI 3
QEVERISJA DHE KOORDINIMI

Megjithëse përgjegjësinë kryesore për mbikëqyrjen e zbatimit të reformave e ka MFE-ja, Strategjia e MFP-së angazhon të gjithë sektorin publik, Kontrollin e Lartë të Shtetit dhe Parlamentin. Prandaj, përgjegjësia për një zbatim të suksesshëm të strategjisë është një përgjegjësi që ndahet mes të gjitha këtyre palëve të interesit në sektorin publik dhe kjo kërkon organizim të qartë dhe të fortë institucional.

KT-ja e MFP-së drejtoi dhe u përfshi në RRA për zbatimin e Strategjisë 2014–2018. Gjatë zbatimit të MFP-së, për periudhën pasardhëse 2019–2022, anëtarët e Komitetit Teknik do të vazhdojnë të mbeten koordinator të objektivave specifikë dhe të komponentëve.

Urdhri i Kryeministrit nr. 157, datë 22.10.2018, "Për marrjen e masave për zbatimin e qasjes së gjerë sektoriale/nënsektoriale, si dhe krijimi dhe funksionimi i mekanizmit të integruar sektorial/ndërsektorial", përcakton Grupin për Menaxhimin e Integruar të Politikave dhe Komitetet Sektoriale Drejtuese. Urdhri përcakton që KD-ja është organi mbikëqyrës për reformën MFP, i cili drejtohet nga ministri i Financave dhe Ekonomisë dhe ka detyrimin, nëpërmjet Sekretariatit të Përgjithshëm, t'i raportojë Komisionit të Planifikimit Strategjik të Këshillit të Ministrave.

Paraprakisht, kuadri i administrimit dhe i monitorimit për reformat në fushën e MFP-së do të përbëhet nga elementet më poshtë:

3.1 Komiteti Drejtues për reformën e MFP-së

KD-ja e reformës e MFP-së[17] është një komitet drejtues me përgjegjësinë për të drejtuar dhe për të monitoruar aktivitetet e reformës së MFP-së. Do të drejtohet nga ministri i Financave dhe Ekonomisë, do të mblidhet çdo gjashtë muaj dhe do të ketë në përbërje anëtarët si më poshtë:

- zëvendësministri për Financat dhe Ekonominë;
- Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë;
- zëvendësministri i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme;
- një përfaqësues nga Kryeministria;
- Sekretari i Përgjithshëm i KLSH-së;
- një përfaqësues nga Komisioni Parlamentar për Ekonominë dhe Financat;
- kreu i Departamentit të Administratës Publike;
- kreu i Agjencisë së Prokurimit Publik;
- kreu i Komisionit të Prokurimit Publik;
- drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve;
- drejtori i Përgjithshëm i Doganave;
- ftohen përfaqësues nga PZHI-ja.

Sekretari i Përgjithshëm i MFE-së do të kryejë rolin e Sekretarit të Komitetit Drejtues. Komiteti do të mblidhet çdo gjashtë muaj për të parë ecurinë e reformave, për të shqyrtuar risqet dhe për të miratuar masat për të zvogëluar risqet. Herë pas herë, KD-ja mund të ftojë persona të tjerë që të marrin pjesë në takime.

Përgjegjësitë e Komitetit Drejtues për reformat MFP përfshijnë si më poshtë:

- caktimin e koordinatorëve të objektivit specifik për secilën nga shtatë fushat në Strategji;
- caktimin e koordinatorëve të komponentëve, bazuar në propozimet e koordinatorëve të objektivit specifik;
- monitorimin e zbatimit të Strategjisë së MFP-së kundrejt objektivave të synuar dhe treguesve të performancës;
- shqyrtimin e risqeve dhe marrjen në konsideratë dhe/ose përcaktimin e masave zbutëse;
- sigurimin e komenteve të përshtatshme për mekanizimin e monitorimit në Drejtorinë për Zhvillim dhe Mirëqeverisje (DZHM);
- zgjidhjen e problemeve të koordinimit që dalin mes palëve të interesit dhe lehtësimin e dialogut politik me DZHM-në;
- brenda kufizimeve buxhetore të PBA-së, shqyrtimin dhe miratimin e propozimeve për planet vjetore të punës dhe buxhetet e komponentëve për secilin objektiv specifik;
- shqyrtimin e planeve të punës dhe raport progresit të Komitetit Teknik të MFP-së;
- propozimin, sipas nevojës, të rialokimeve ndërmjet komponentëve;
- marrjen dhe shqyrtimin e raportprogresit nga koordinatorët e të gjithë objektivave specifikë të MFP-së;
- dialogimin me PZHI-në për ecurinë, mbështetjen dhe objektin e reformave.
- takime të posaçme për të diskutuar gjetjet dhe rekomandimet analizave të jashtme teknike. Mbajtjen e takimeve konsultative me PZHI-në, OSHC-të dhe akademikët.

---

[17] Për të garantuar zbatimin efektiv të reformave dhe për të bashkërenduar përpjekjet, u ngrit një Komitet Drejtues më urdhër Kryeministri nr. 202, datë 25.8.2014.

3.2 Komiteti Teknik për reformën e MFP-së

Në vitin 2017, u krijua KT me mandatpërshpejtimin e masave të reformës, i cili kishte një përbërje të gjerë, ku sipas RRA-së anëtarësia nuk bënte dallim mjaftueshëm nga KD-ja dhe rezultonte në dublim funksionesh. Prandaj propozohet që KT-ja të ketë në përbërje vetëm koordinatorët e objektivit specifik dhe të komponentëve për të mundësuar një planifikim të hollësishëm dhe monitorim të planeve vjetore. KT-ja do të koordinojë dhe do të monitorojë zbatimin e produkteve që gjenden në komponentë të ndryshëm të objektivave specifikë respektivë. Më e rëndësishmja është se do të identifikojë risqet, do të planifikojë zbutjen e tyre dhe do të informojë Sekretarin e Përgjithshëm për këto çështje, sipas nevojës. KT-ja do të vijojë të drejtohet nga Sekretari i Përgjithshëm i MFE-së.

Komiteti do të mblidhet sipas nevojës, por jo më pak se dy herë në vit. Komiteti do të mbështetet nga DMRFP-ja. Sipas nevojës, persona të tjerë teknikë mund të caktohen të marrin pjesë në takimet e KT-së, me kërkesë të Sekretarit të Përgjithshëm.

3.3 Drejtoria e Reformave në Fushën e MFP-së

Sekretari i Përgjithshëm dhe KT-ja do të mbështeten nga DMRFP-ja. Drejtoria do të vijojë të mbetet përgjegjëse për monitorimin dhe raportimin e reformave:

- shqyrtimin e shtatë planeve të punës së objektivave specifikë;
- shqyrtimin e raportprogresit gjashtëmujor të objektivave specifikë;
- raport përmbledhës mbi për ecurinë e MFP-së, arritjet, rastet kur progresi është jashtë planit, sfidat dhe risqet, çdo gjashtë muaj dhe në bashkëpunim me koordinatorët e objektivave specifikë;
- përgatitjen e raportit vjetor të monitorimit rreth ecurisë së Strategjisë së MFP-së; dhe
- drejtori mbështet Komitetin Drejtues për të siguruar se janë identifikuar risqet për zbatimin e planit të veprimit dhe se janë zbatuar rekomandimet e Komitetit Teknik dhe të Komitetit Drejtues.

3.4 Komitetet e koordinimit të objektivave specifikë të Strategjisë

Poshtë nivelit të Komitetit Teknik rekomandohet që të krijohen edhe shtatë KK, një për secilin objektiv specifik, të cilët do të mblidhen çdo gjashtë muaj, por idealja do të ishte çdo tre muaj. Koordinatorët e komponentëve dhe anëtarët caktohen nga koordinatorët e objektivit specifik përkatës. Qëllimi është të shqyrtohen aktivitetet e hollësishme të kryera në kuadër të planit të punës të objektivave specifikë, në mënyrë që të mundësohet bashkërendimi ndërmjet palëve të interesit të komponentëve dhe të trajtohen mangësitë dhe hendeqet për t'u siguruar që progresi të ecë në rrugën e duhur. Në kthim, KK-të do të ngrenë problemet që kanë nevojë për zgjidhje deri në nivelin e Komitetit Drejtues dhe Komitetit Teknik, sipas nevojës. Koordinatorët e objektivave specifikë do të jenë përgjegjës, për: hartimin e planeve të punës ku do të përcaktohen qartë produktet e projektit dhe afatet kohore; sigurimin që rezultatet dhe rekomandimet e çdo vlerësimi të jashtëm dhe raportet e asistencës teknike të shpërndara vazhdimisht të merren parasysh; dhe hartimin e raporteve përmbledhëse 6-mujore për zbatimin e reformës. Sekretari i Përgjithshëm, si kryetar i komitetit teknik, do të monitorojë produktet dhe rregullsinë e këtyre mbledhjeve.

3.5 Koordinatorët e objektivave specifikë

Koordinatorët, pas emërimit, do të vlerësojnë në vazhdimësi ecurinë e arritjes së objektivit përkatës. Ata janë përgjegjës të drejtojnë mbledhjen e KK-së të objektivit përkatës, të kontribuojnë në kostimin e planeve vjetore të punës, të përgatisin propozimet financiare për objektivin specifik dhe raportprogresin gjashtëmujor për secilin nga objektivat specifikë. Ata do të vlerësojnë risqet e zbatimit të strategjisë, si dhe të propozojnë masat zbutëse dhe ndërmarrin masa korrigjuese, nëse është e nevojshme. Gjithashtu, duhet të sigurojë që reforma të komunikohet brenda QSH-së dhe publikut, OSHC-ve dhe akademikëve.

3.6 Koordinatorët e komponentëve

Koordinatorët e emëruar të komponentëve do të jenë përgjegjës për nxitjen e vazhdueshme të aktiviteteve të reformës nën secilin komponent, ku përfshihet hartimi i planeve të punës dhe

raportet për ecurinë e aktiviteteve, sfidave, realizimeve dhe vonesave në përmbushjen e produkteve.

3.7 Partnerët e jashtëm

KD-ja për MFP-në do të shërbejë si një forum për dialog dhe ndarje mendimesh nga partnerët e jashtëm të Shqipërisë, për Strategjinë e MFP-së dhe zbatimin e saj. Takimet që u kushtohen reformave të MFP-së do të mbahen të paktën një herë në vit.

Shqyrtimet e jashtme teknike të ardhshme, si ato që përbëjnë bazën për konsultimet në bazë të nenit IV me FMN-në, shqyrtimet e financave publike dhe shqyrtime të tjera të rëndësishme nga Banka Botërore, raportet monitoruese të MPQM-së, shqyrtimet SHPPF, vlerësimet e pajtueshmërisë së BE-së dhe IBH-së do të ofrojnë kontribut për dialogun në Grupin Sektorial të Punës (GSP) dhe për diskutimet e Komitetit Drejtues të MFP-së.

Një kontribut i rëndësishëm në strategjinë e reformës së MFP-së dhe planit të veprimit 2019–2022 ishte konsultimi publik i RRA-së me shoqërinë civile, akademikët dhe donatorët, të cilat janë kryer në pranverë të vitit 2019. Këto konsultime kishin si qëllim që të merrnin dhe të reflektonin komentet dhe shqetësimet që ata kanë për përmbajtjen dhe prioritetet e strategjisë dhe planit të veprimit.

3.8 Koordinimi i reformave të TI-së

MFE-ja është në procesin e finalizimit të zbatimit të një sistemi gjithëpërfshirës, të automatizuar për të forcuar MFP-në brenda SPI-së. Komponentët kyç të sistemeve të menaxhimit të informacionit të SPI-së përfshijnë SIMFSH-në dhe sistemin informatik SPI (IPSIS). Këto platforma do të ndërlidhen edhe me SIMAJ. SIMFSH-ja është krijuar për të qenë një zgjerim i SIFQ-së ekzistuese, por me module shtesë funksionale, për "Programin buxhetor afatmesëm"; "Menaxhimin e investimeve publike"; integrimin e komponentëve shtesë me sistemin ekzistues të thesarit. Qëllimi kryesor i zgjerimit të sistemit është që të garantohet një zgjidhje e vetme, plotësisht e integruar dhe homogjene për të mbuluar strategjinë, planifikimin dhe buxhetimin, në lidhje me strategjitë kombëtare, sektoriale dhe ndërsektoriale.

Një pamje e përgjithshme e vizionit të TI-së, për shumicën e sistemeve të MFP-së, paraqitet në figurën 1 më poshtë.

Figura 1. Arkitektura e sistemit të MFP-së



Që prej muajit nëntor 2017, Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit (AKSHI) zgjeroi aktivitetin nga pikëpamja e kapaciteteve njerëzore dhe teknike, me qëllim përmirësimin e sistemeve ekzistuese qeveritare, përfshirë ato që menaxhohen nga MFE-ja, si dhe të ndërtojë të reja. Megjithëse Agjencia është përgjegjëse për zbatimin e politikave për zhvillimin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, është krijuar një drejtori e re në MFE për të monitoruar më nga afër performancën e SIMFSH-së dhe për të mbështetur përdoruesit e sistemit. Gjithashtu, për të vlerësuar dhe për të monitoruar gatishmërinë në rast ndryshimesh dhe për angazhimin e nivelit drejtues, si dhe për ndryshime të mëdha në Strategjinë MFP, nga ana e MFE-së është përgatitur një Strategji Komunikimi.

Reformat që janë planifikuar brenda objektivit specifik përkatës përfshijnë aktivitete të rëndësishme që kanë si qëllim përmirësimin dhe integrimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit (TI-së). Këto sisteme përshkojnë të gjithë objektivat specifikë të strategjisë dhe duhen bërë përpjekje shtesë për të siguruar bashkërendimin e aktiviteteve, si dhe arritjen e efikasitetit ekonomik, aty ku është e mundur.

Komponentët dhe masat brenda strategjisë janë sipas shtatë objektivave specifikë dhe përmbajnë:

Rregullat fiskale dhe parashikimet 1.1.2.2 Blerja dhe përdorimi i programeve të TI-së për modelet për parashikimin e të ardhurave;

Zhvillimi i politikave dhe qeverisja strategjike e integruar 2.1.5 Menaxhimi dhe zbatimi i sistemit IPSIS;

PBA 2.2.1.2 Zbatimi i plotë i SIMFSH-së te të gjitha institucionet buxhetore që mbështetin zbatimin e PBA-së;

MFP-ja në qeverisjen vendore 2.4.5 Sistemi i planifikimit të integruar, i krijuar për njësitë e vetëqeverisjes vendore;

Administrata tatimore 3.1.2 Përgatitja e procedurave të automatizuara të bazuara në risk për menaxhimin e rimbursimit të TVSH-së; 3.1.3 Riprojektimi dhe kompjuterizimi i proceseve kryesore tatimore; 3.1.7 Zbatimi i planit për përmirësimin e menaxhimit të borxhit tatimor (DPT);

Kadastra fiskale 3.2.1.1 Zhvillimi i versionit të parë të sistemit të centralizuar të TI-së për taksën mbi pronën;

Menaxhimi i doganave 3.3.2 Zhvillimi dhe mirëmbajtja e një sistemi gjithëpërfshirës për menaxhimin e riskut (Drejtoria e Përgjithshme e Doganave);

Zgjerimi/rritja e përdorimit të SIFQ-së 4.1.1 dhe 4.1.2 Integrimi i SIMBNJ-së dhe krijimi i ndërfaqeve me doganat;

Prokurimet publike 4.4.3 Vazhdimi i zhvillimit të sistemit të prokurimit elektronik dhe 4.4.4 përfundimi i integrimit të sistemit e- Procurement me SIFQ (APP);

Kontabiliteti 4.6.3 Vlerësimi i ndryshimeve funksionale të SIFQ-së që duhen për të bërë të mundur zbatimin e kontabilitetit me të drejta dhe detyrime të konstatuara;

Llogaritë Kombëtare 5.1.1 Krijimi i një sistemi statistikor të automatizuar për sektorin publik.

Për të bërë të mundur koordinimin, drejtuesit e njësive përgjegjës për zbatimin e SIMFSH-së do të mblidhen çdo tre muaj për të diskutuar strukturimin e aktiviteteve, planeve të punës dhe progresin e bërë. Një raport i shkurtër për progresin dhe sfidat e zbatimit dhe integrimit të sistemeve të TI-së do të dorëzohet pranë Komitetit Drejtues.

KAPITULLI 4
VLERËSIMI I KOSTOVE DHE FINANCIMI

Shumica e reformave të përfshira në këtë strategji janë reforma të politikave. Puna e formalizimit të këtyre reformave në formën e legjislacionit dhe të rregulloreve të reja dhe/ose të ndryshuara nuk do të kërkojë burime financiare shtesë. Stafi ekzistues i institucioneve të përfshira në zbatimin e reformave do të jetë përgjegjës për marrjen e masave të nevojshme për realizimin e masave e parashikuara në këtë dokument strategjik.

Qasja e përdorur për të matur fushëveprimin e burimeve të përdorura për zbatimin e strategjisë PFM është kosto e plotë.

Qeveria do të kërkojë financim partnerët e jashtëm për zhvillim dhe integrim, për të financuar hendekun për të mbuluar shpenzimet që lidhen zbatimin e kapaciteteve dhe të ngritjes së kapaciteteve. Qeveria mbetet e angazhuar të sigurojë mbulimin e hendekut financiar për të lejuar zbatimin e aktiviteteve të reformës. Detaje të mëtejshme mbi hendekun financiar, sipas produkteve, gjenden në kapitullin 5.

Shuma në EURO

		Financim i Brendshëm	A-TA	A-Capex	P-Capex	R-TA	R-Capex	TOTALI	Financim i Huaj	Hendeku i financimit
1	**Kuadër fiskal i qëndrueshëm dhe i matur**	**462.333**	**0**	**0**	**0**	**40.000**	**30.000**	**532.333**	**0**	**70.000**
1.1	Rregullat fiskalë dhe parashikimi	234.547	0	0	0	20.000	30.000	284.547	0	50.000
1.2	Menaxhimi i riskut fiskal	227.787	0	0	0	20.000	0	247.787	0	20.000
2	**Planifikim i mirëintegruar dhe efikas**	**7.841.047**	**8.628.481**	**0**	**0**	**1.580.000**	**600.000**	**18.649.527**	**8.628.481**	**2.180.000**
2.1	Zhvillimi i politikave dhe qeverisje e integruar strategjike	6.047.227	480.230	0	0	0	0	6.527.457	480.230	0
2.2	Programi buxhetor afatmesëm	1.238.590	1.047.619	0	0	0	0	2.286.209	1.047.619	0
2.3	Planifikimi dhe mbikëqyrja e investimeve publike	185.077	2.870.000	0	0	60.000	0	3.115.077	2.870.000	60.000
2.4	MFP në financat vendore	370.153	4.230.632	0	0	1.520.000	600.000	6.720.785	4.230.632	2.120.000
3	**Mbledhja e të ardhurave**	**23.159.502**	**3.920.000**	**9.991.667**	**2.640.000**	**880.000**	**566.667**	**41.157.835**	**13.911.667**	**4.086.667**
3.1	Administrimi I taksave	10.815.001	0	0	0	0	100.000	10.915.001	0	100.000
3.2	Kadastra fiskale e pronës	0	3.500.000	0	0	0	0	3.500.000	3.500.000	0
3.3	Manaxhimi I doganave	12.344.501	420.000	9.991.667	2.640.000	880.000	466.667	26.742.834	10.411.667	3.986.667
4	**Ekzekutimi efikas i buxhetit**	**3.358.642**	**375.833**	**0**	**0**	**110.000**	**2.334.038**	**6.178.513**	**375.833**	**2.444.038**
4.1	Zgjerimi I përdorimit të SIFQ	355.917	0	0	0	50.000	1.072.490	1.478.406	0	1.122.490
4.2	Kontrolli i angazhimeve shumëvjeçare dhe llogaritë e pague	484.047	0	0	0	0	0	484.047	0	0
4.3	Borxhi dhe Menaxhimi I Likujditetit	313.207	375.833	0	0	0	0	689.040	375.833	0
4.4	Prokurimi Publik	1.080.775	0	0	0	60.000	1.261.549	2.402.324	0	1.321.549
4.5	Manaxhimi I fondeve të huaja	370.153	0	0	0	0	0	370.153	0	0
4.6	Forcimi i Rolit të Ndihmës Shtetërore	754.543	0	0	0	0	0	754.543	0	0
5	**Transparenca e Financave Publike**	**7.768.870**	**2.366.893**	**0**	**0**	**20.000**	**0**	**10.155.763**	**2.366.893**	**20.000**
5.1	Llogaritë Kombëtare të Qeverisë	7.256.350	85.345	0	0	0	0	7.341.695	85.345	0
5.2	Monitorimi dhe raportimi financiar dhe i performancës	0	952.381	0	0	0	0	952.381	952.381	0
5.3	Angazhimi I Qytetarëve	313.207	0	0	0	0	0	313.207	0	0
5.4	Kontabiliteti	0	1.282.529	0	0	0	0	1.282.529	1.282.529	0
5.5	Manaxhimi I Aseteve I Përmirësuar	199.313	46.637	0	0	20.000	0	265.951	46.637	20.000
6	**Kontroll i Brendshëm Efektiv**	**896.910**	**0**	**0**	**0**	**155.000**	**0**	**1.051.910**	**0**	**155.000**
6.1	Menaxhimi financiar dhe kontrolli në të gjitha institucionet	569.467	0	0	0	68.000	0	637.467	0	68.000
6.2	Auditimi I Brendshëm	128.130	0	0	0	27.000	0	155.130	0	27.000
6.3	Inspektimi Financiar Publik	199.313	0	0	0	60.000	0	259.313	0	60.000
7	**Mbikëqyrja efektive e jashtme e financave publike**	**5.322.353**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**5.322.353**	**0**	**0**
7.1	Auditimi i Jashtëm	5.322.353	0	0	0	0	0	5.322.353	0	0
		48.809.656	**15.291.207**	**9.991.667**	**2.640.000**	**2.785.000**	**3.530.705**	**83.048.234**	**25.282.873**	**8.955.705**

Legjenda	
R-Capex	Ndihmë për blerjen e mallrave të reja kapitale - jo të planifikuara në PBA - hendeku i financimit
R-TA	Kerkohet asistencë teknike - hendeku i financimit
